

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5914  
E shtunë, 26 tetor 2019  
çmimi 0.40 €

Thaçi merr pjesë në  
Samitin për Paqe të  
Evropës Juglindore 2019

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", FADIL MALOKU | FAQE 4-5



## Perceptimi për zgjedhje shembullore ishte i ngutshëm

Ish-anëtari i KQZ-së, Fadil Maloku, ka deklaruar se perceptimi që Kosova ka organizuar zgjedhje shembullore ishte i ngutshëm. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka treguar se të

metat e këtij procesi filluan të shfaqen pas ditës së zgjedhjeve. Maloku ka bërë me dije se vetëm një reformë e mirëfilltë zgjedhore do t'i eliminonte anomalitë e sistemit aktual zgjedhor. Sipas tij,

reforma zgjedhore duhet ta eliminojë përfaqësimin politik në KQZ, duhet të ndryshojë mënyra e përzgjedhjes së komisionarëve dhe të centralizohet numërimi i votave për kandidatët për deputetë

## Javën e ardhshme publikohen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit

Më së largu në fillim të javës së ardhshme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do t'i publikojë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit. Lajmin e ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re", zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Ai ka treguar se deri më tani janë numëruar më shumë se gjysma e votave me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta | FAQE 3



**Kurti:**  
Prioritetet e qeverisë së re, zhvillimi ekonomik dhe luftimi i korrupsionit

FAQE 6

### AKTUALE



**NIS FUSHATA VETËDIJESUESE PËR ULJEN E AKSIDENTEVE FATALE NË KOMUNIKACION F. 7**

**MJEKU NGA AUSTRALIA DO T'I OPEROJË 25 FËMIJË ME PROBLEME KIRURGIKE F. 6**

### EKONOMI

**TË BËRIT BIZNES, MES LEHTËSIVE LIGJORE DHE BUROKRACISË INSTITUCIONALE F. 9**

**VETERINARËT MËSOJNË METODAT BASHKËKOHORE TË MIRËQENIES SË KAFSHËVE TË SHOOËRIMIT F. 9**



### KULTURË

**AGIM VINCA SJELL LIBRIN ME POEZI 'ENGJËJT PËSHPËRITIN NË MËNGJES' F. 16**

### SPORT

**FERONIKELI 'KËRCËNON' DRENICËN ME HUMBJE F. 20**

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Johnson: Kosova dhe Serbia kërkuar angazhim më të madh të ShBA-së

UASHINGTON, 25 TETOR - Prishtina dhe Beogradi donin një angazhim më të madh të Shteteve të Bashkuara për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, madje kërkuar që edhe unë të angazhohem për këtë, tha senatori republikan në Uashington, Ron Johnson.

Në një intervistë për "Zërin e Amerikës" në gjuhën serbe, Johnsoni tha se i dërguari i posaçëm i Shtëpisë së Bardhë për dialogun, Richard Grenell, dhe përfaqësuesi special i Departamentit amerikan të Shtetit për Ballkanin, Matthew Palmer kanë plan të përbashkët për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, fokusi kryesor i të cilit është ekonomia.

Johnsoni tha se Kosova duhet të formojë qeverinë dhe se nuk dëshiron të japë "afate artificiale", për kohën kur mund të arrihet marrëveshja.

"Palmer dhe Grenell janë duke bashkëpunuar. Unë kam biseduar me të dy dhe e di se kanë plan, i cili përqendrohet në mundësitë ekonomike. Unë mendoj se ata mund të arrijnë diçka dhe pastaj të përipiqen t'i kthejnë të dyja palët në tryezë që të punojnë së bashku", tha senatori amerikan, i cili është kryetar i Nën-komitetit për Evropën dhe Bashkëpunimin Rajonal.

Johnsoni theksoi se do të ishte mirë që Kosova të heqë taksën që u ka vënë prodhimeve të

importuara nga Serbia, ndërsa Beogradit i bëri thirrje që të ndalojë të kërkojë nga vendet e tjera t'i tërheqin njohjet për Kosovën.

"Ky do të ishte një hap i rëndësishëm. Mendoj se edhe Palmer edhe Grenell kërkojnë një lloj investimi që do t'i inkurajojë të dyja vendet të bashkëpunojnë. Ne po bëjmë gjithçka që mundemi për të promovuar mundësi më të mira ekonomike, për tërheqjen e investimeve dhe për të dërguar sinjal te qytetarët e të dyja vendeve se këto do të jenë rezultat i një marrëveshjeje të suksesshme", tha senatori Johnson. Ai theksoi se fundi i këtij viti nuk është afat real për zgjidhjen e



çështjes së Kosovës dhe tha se është mirë të shkohet "hap pas hapi".

I dërguari i posaçëm Grenell ka vizituar ditë më parë Prishtinën dhe Beogradin, duke takuar krerët më të lartë të të dyja

shteteve.

Ai ka theksuar në Prishtinë se një marrëveshje ndërmjet dy shteteve do të vë themelin për rritje ekonomike dhe do të kontribuojë për mirëqenien e gjithë qytetarëve.

## Albin Kurti në Tiranë, takohet me kryeministrin Rama

Në takimin e parë pas zgjedhjeve në Kosovë, mësohet se një nga temat e bisedimeve mes kryeministrit Rama dhe Albin Kurtit që pret të marrë detyrën e kryeministrit të Kosovës është edhe krijimi i një ministrie të veçantë me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve në mes Shqipërisë dhe Kosovës



TIRANË, 25 TETOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër të Kosovës, Albin Kurti të premten në mbrëmje është takuar me kryeministrin shqiptar Edi Rama, në kryeministri.

Ndrishe nga të gjithë zyrtarët e tjerë, Kurti nuk ka mbërritur në Kryeministri me eskortë.

"Nuk erdhi me eskortë, i shoqëruar nga automjete. Doli shefi i protokollit në Presidencë dhe e prit dhe tashmë është futur në Kryeministri për një takim joformal me kryeministrin Edi Rama. Ishte një takim i parajlmëruar.

Ajo që është deklaruar se do të diskutohen shumë çështje por pa i specifikuar ato", ka njoftuar Ora News.

Ky është takimi i parë i tyre pas fitores së zgjedhjeve të Lëvizjes Vetëvendosje më 6 tetor në Kosovë. Burimet thonë se takimi është joformal dhe nuk do të ketë asnjë deklaratë për mediet.

Por mësohet se një nga temat e bisedimeve mes kryeministrit Rama dhe Albin Kurtit që pret të marrë detyrën e kryeministrit të Kosovës është edhe krijimi i një ministrie të veçantë me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve në mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Kjo ide i ka pëlqyer edhe kreut të Vetëvendosjes, Albin Kurti.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti i cili ka dalë fitues zgjedhjeve, e ka konfirmuar të premten se do të udhëtojë në Tiranë ku do të takohet me kryeministrin shqiptar, Edi

Rama.

"Do të udhëtoj në Tiranë ku do të marrë pjesë në një konferencë që do të mbahet këtë vikend, në të njëjtën kohë do të takohem edhe me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama", ka thënë Kurti gjatë vizitës në panairin "Agrokos" në

kryeqytet.

Të enjten Albin Kurti zhvilloi një vizitë në Gjermani, ndërsa pati takime të rëndësishme me personalitete të fushës së politikës. Ai theksoi se Kosova do të forcojë më tej bashkëpunimin me Gjermaninë në disa fusha.

## Basha: Dialog, jashtë Kuvendit

TIRANË, 25 TETOR - Lideri i demokratëve, Lulzim Basha mirëpriti gatishmërinë e OSBE për të lehtësuar dialogun politik me mazhorancën parlamentare, por refuzoi idenë e socialistëve që misioni të luante rolin e "shkuesit" mes palëve për reformën zgjedhore.

"Këto janë budallallëqe, merri këtë, çoi atje, budallallëqe. Janë heqje përgjegjësie. Si do të bëhet Basha? Ashtu siç bëhet dialogu politik. Ashtu siç janë zgjidhur krizat politike edhe në Shqipëri dhe në vendet fqinje", u shpreh

Basha.

Rolin e ndërmjetësit për t'i rivendosur urat e komunikimit sekretari i përgjithshëm i OSBE-së, Thomas Graminger ua propozoi personalisht drejtuesve të opozitës jashtëparlamentare në takimin që pati me ta në selinë e PD-së.

"Mund të ofrojmë hapësirë për dialog. Këtë mund të bëjmë. Ajo që nuk mund të bëjmë është të marrim vendime politike për hapat që duhet ndërmarrë në fushën e reformës zgjedhore. Shpresojmë që rekomandimet e

ODIHR po merren seriozisht dhe po zbatohen. Ajo çfarë nuk mund të bëjmë është të zgjedhim sistemin zgjedhor që ky vend do të zgjedhë", ka thënë sekretari i përgjithshëm të OSBE-së, Thomas Graminger.

"Dialogu do të zhvillohet jashtë dyerve të pseudoparlamentit deri sa të kemi një parlament që është produkt i votës së qytetarëve dhe jo i bandave kriminale. Për opozitën, rruga është e qartë, është e njëjta rrugë që përshkruhet edhe nga kushtet e Bundestagut - miratimi i reformës dhe zgjedhje të



parakohshme parlamentare në një ditë me zgjedhje kushtetuese vendore", ka thënë Basha. Tentative e osbe për të zgjidhur

krizën politike nuk është e vetmja. Në Tiranë në fund të tetorit pritet të vijë dy reporter nga Këshilli i Europës.

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është duke vazhduar procesi i numërimit të votave me kusht dhe atyre të personave me nevoja të veçanta

# Javën e ardhshme publikohen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit

Më së largu në fillim të javës së ardhshme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do t'i publikojë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit. Lajmin e ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Ai ka treguar se deri më tani janë numëruar më shumë se gjysma e votave me kusht dhe atyre të personave me nevoja të veçanta



tërësi grumbullin e fletëvotimeve të ardhura nga Serbia", është thënë në njoftimin e PZAP-së. Po ashtu, PZAP ka hedhur poshtë edhe ankesën e Partisë Liberale Egjiptiane (PLE) që ka kërkuar rinumërim të 198 vendvotimeve. "Paneli ka shqyr-

tuar edhe ankesën: Anr. 377/2019, të 23. 10. 2019, e parashtruar nga Veton Berisha, kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me anë të së cilës ka kërkuar që ta urdhërojë

KQZ-në për rinumërim të 198 vendvotimeve të cilat nuk kanë qenë të përfshira në rinumërimin nga ana e KQZ-së për zgjedhjet e parakohshme të 06. 10. 2019. Të dy ankesat janë hedhur të palejuara", është theksuar më tutje në njoftimin e PZAP-it.



## Thaçi merr pjesë në Samitin për Paqe të Evropës Juglindore 2019

Prishtinë, 25 tetor (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, do të marrë pjesë në Samitin për Paqe të Evropës Juglindore 2019 në Tiranë, i cili organizohet nga Federata Universale e Paqes. Në këtë

samit presidenti Thaçi do të flasë për perspektivën e paqes në Ballkan. Samiti zhvillon punimet prej 25 deri më 27 tetor dhe tema kryesore të tij janë paqja, siguria dhe zhvillimi human i Evropës Juglindore.

### **EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 TETOR - Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka thënë të premten se në fillim të javës së ardhshme do të publikohen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Ai ka bërë me dije se pas numërimit të votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta, KQZ-ja do të jetë e gatshme t'i shpallë rezultatet finale. "Tashmë jemi në fazën përfundimtare dhe me përfundimin e numërimit të votave me kusht, votave të personave me nevoja të veçanta si dhe rinumërimit të katër vendvotimeve do të jemi të gatshëm ta shpallim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit", është shprehur Elezi për gazetën "Epoka e re".

Ai ka theksuar se pas shpalljes së rezultateve përfundimtare subjektet politike dhe kandidatët e tyre mund t'i paraqesin ankesat në Panelin Zgjedhor të Ankesave dhe Parashtresave (PZAP) brenda 24 orëve. "Pra, pas shpalljes së rezultatiit përfundimtar fillon afati 24 orësh për subjektet politike dhe kandidatët e tyre që t'i paraqesin ankesat e tyre në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). KQZ-ja duhet t'i presë vendimet e tyre për ta përmbyllur këtë proces zgjedhor", ka deklaruar Elezi.

Ai ka treguar se deri në pasditen e së premtes janë numëruar më shumë se gjysma e votave me kusht dhe atyre të personave me nevoja të veçanta. "Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultatit është duke vijuar procesi i numërimit të votave me kusht dhe votave të personave me

nevoja të veçanta ku janë rreth 27 mijë gjithsej. Deri në orën 15:00 janë numëruar më shumë se 13 000 vota dhe po besojmë se deri nesër (e shtunë) do ta përmbyllim procesin e numërimit të këtyre fletëvotimeve", ka thënë Elezi, duke shtuar se po të shtunën do të rinumërohen edhe katër vendvotime për të cilat ka vendosur KQZ-ja të premten. "Nesër (e shtunë) do ta fillojmë numërimin e katër vendvotimeve për të cilat ka vendosur KQZ-ja në mbledhjen e së premtes", ka thënë ai.

Nga numërimi i 13 408 votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta, 3 747 ka marrë Lëvizja Vetëvendosje (LV), e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 2 815 dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 2 641. Koalicioni AAK-PSD ka marrë 2 045 vota, ndërsa koalicioni Nisma-AKR-PD ka marrë 622 vota.

### **PZAP-I HEDH POSHTË ANKESËN E KOALICIONIT NISMA-AKR-PD PËR VOTAT E ARDHURA NGA SERBIA**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) të premten ka hedhur poshtë ankesën e koalicionit Nisma-AKR-PD për votat e ardhura në zarrë nga Serbia. "Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) në seancën e mbajtur më 25. 10. 2019 ka shqyrtuar ankesën: Anr. 378/2019 e paraqitur nga koalicioni Nisma-AKR-PD më 24. 10. 2019 me të cilën ka kërkuar nga PZAP-i që ta aprovojë ankesën e këtij subjekti dhe të urdhërohet KQZ-ja që të anulohet, përjashtojë nga rezultati i numërimit në

Flet për "Epokën e re", Fadil Maloku

# Perceptimi për zgjedhje she

Ish-anëtari i KQZ-së, Fadil Maloku, ka deklaruar se perceptimi që Kosova ka organizuar zgjedhje shembullore ishte i ngutshëm. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka treguar se të metat e këtij procesi filluan të shfaqen pas ditës së zgjedhjeve. Maloku ka bërë me dije se vetëm një reformë e mirëfilltë zgjedhore do t'i eliminonte anomali të e sistemit aktual zgjedhor. Sipas tij, reforma zgjedhore duhet ta eliminojë përfaqësimin politik në KQZ, duhet të ndryshojë mënyra e përzgjedhjes së komisionarëve dhe të centralizohet numërimi i votave për kandidatët për deputetë

**EPOKA E RE** **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 25 TETOR - Ish-anëtari i KQZ-së, Fadil Maloku, ka bërë me dije se vlerësimet pozitive për procesin zgjedhor kanë qenë të ngutshme. Ai ka deklaruar se tek pas ditës se zgjedhjeve kanë ardhur në shprehje dobësitë e këtij procesi. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Maloku ka deklaruar se të metat e këtij procesi duhet të eliminohen përmes një reforme zgjedhore. "Perceptimi ynë për zgjedhje shembullore ishte i ngutshëm për shkak se, siç po shihet, zgjedhjet nuk kanë mbaruar ende, po stërzgjatet procesi dhe po dalin dobësi të ndryshme", ka thënë Maloku.


Maloku ka treguar dobësitë kryesore të ligjit aktual zgjedhor. "Vetëm një reformë e mirëfilltë zgjedhore do t'i eliminonte anomali të e sistemit

aktual zgjedhor. Tanimë kemi organizuar disa palë zgjedhje me këtë ligj dhe i kemi vërejtur mirë dobësitë e këtij ligji. Në reformën e ardhshme zgjedhore do të duhej të eliminohet përfaqësimi politik në KQZ.

Anëtarët e KQZ-së nuk do të duhej të ishin përfaqësues të subjekteve politike. Anëtarët e KQZ-së do të duhej të ishin gjyqtarë të dëshmuar në karrierën e tyre", është shprehur ai. Maloku ka deklaruar se komi-

sionarët janë ata që vazhdimisht kanë deformuar proceset zgjedhore në Kosovës. Sipas tij, do të duhej të ndryshohej mënyra e përzgjedhjes së komisionarëve. "Vetë fakti se ata i zgjedhin partitë,

komisionarët mund të jenë njerëz që janë të gatshëm të veprojnë jo në mënyrë të drejtë. Edhe sa kam qenë anëtar i KQZ-së kam njohur njerëz që kanë qenë në gjendje të korruptohen. Do të ishte mirë që




## Gjykata Supreme vendos për numërimin e votave të mërgatës

PRISHTINË, 25 TETOR - Gjykata Supreme ka miratuar ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje për numërimin e votave të mërgatës. Këtë e ka bërë me dije LV-ja përmes një njoftimi në profilin e vet në "Facebook". "Mijëra dërgesa me fletëvotime të bashkatdhetarëve të nisura brenda afatit dhe para datës së zgjedhjeve, e të cilat padrejtësisht Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve nuk i kishte shqyrtuar dhe numëruar, me vendimin e sotëm të Gjykatës Supreme ato do të numërohen dhe do të bëhen pjesë e rezultatit të zgjedhjeve", është thënë në njoftimin e LV-së.

Sipas këtij subjekti politik, e drejta e votës si e drejtë kushtetuese është e garantuar dhe nuk mund të mohohet me justifikime teknike që bien ndesh me ligjet dhe

Kushtetutën e Republikës. "Andaj, Gjykata Supreme shmangi një padrejtësi të madhe, e konfirmoi një të drejtë kushtetuese të mijëra votuesve nga mërgata. Kërkojmë që pa humbur kohë të fillojë shqyrtimi dhe numërimi i këtyre fletëvotimeve, që vullneti i votuesve nga mërgata të përfshihet në rezultatit përfundimtar", është thënë në njoftimin e LV-së.



# mbullore ishte i ngutshëm



bëhet në vendvotim. Pra, kutitë të mos hapen në vendvotime, por ato të barten në QNR dhe numërimi të bëhet aty. Vetëm kështu mund t'u ikim parregullive të mundshme nga ana e komisionarëve. Sepse kjo mënyrë e rinumërimit të votave po na e zbeh gjithë procesin zgjedhor dhe po e zvarrit shumë përfundimin e këtij procesi", ka thënë Maloku.

**"Epoka e re":** Z. Maloku, vlerësimeve të përgjithshme, se Kosova më 6 tetor ka zhvilluar proces të mirë zgjedhor, u ka humbur shkëlqimi. Pse?

**Maloku:** Mua po më duket se perceptimi ynë i parë, se zgjedhjet kanë qenë të përkryera, ka qenë i ngutshëm. Krahasimin për organizimin e këtyre zgjedhjeve nuk e kemi bërë me zgjedhjet të cilat i organizojnë shtetet e rajonit dhe vendet që kanë traditë të gjatë demokratike. Krahasimin e kemi bërë me zgjedhjet tona të mëparshme. Pra, këtë proces e kemi krahasuar me shtatë palë zgjedhjet që i kemi organizuar deri me tani. Do të thotë, perceptimi ynë për zgjedhje shembullore ishte i ngutshëm për shkak se, siç po shihet, zgjedhjet nuk kanë mbaruar ende dhe që po stërzgjetet procesi dhe po dalin dobësi të ndryshme.

**"Epoka e re":** Si do të mund të eliminohen këto dobësi?

**Maloku:** Këtu më së shumti janë bërë vërejtjet brendapartiake, pra te komisionet partiake sesa në mes të partive. Pra, vërejtjet ndaj procesit kryesisht kanë qenë për vjedhje brenda llojit. Kjo na bënë të jemi shumë të kujdesshëm dhe ta shikojmë mundësinë e një reforme të mirëfilltë zgjedhore, e cila do ta ndryshonte ligjin aktual zgjedhor.

**"Epoka e re":** Çfarë do të duhej të ndryshohej në ligjin aktual

zgjedhor?

**Maloku:** Vetëm një reformë e mirëfilltë zgjedhore do t'i eliminonte anomalitë e sistemit aktual zgjedhor. Tanimë kemi organizuar disa palë zgjedhje me këtë ligj dhe i kemi vërejtur mirë dobësitë e këtij ligji. Në reformën e ardhshme zgjedhore do të duhej të eliminohej përfaqësimi politik në KQZ. Anëtarët e KQZ-së nuk do të duhej të ishin përfaqësues të subjekteve politike. Anëtarët e KQZ-së do të duhej të ishin gjyqtarë të dëshmuar në karrierën e tyre. Paramendoni 40 për qind të anëtarëve në KQZ përfaqësojnë komunitetet, kurse 60 për qind përfaqësojnë shqiptarët. Kjo nuk ndodh askund në botë. Ky është diskriminim pozitiv i cili në reformën e ardhshme duhet të ndryshojë. Kjo reformë do të duhej t'i parashihte si anëtarë të KQZ-së shtatë gjyqtarë. Njëri prej tyre do të duhej t'u takonte minoriteteve por, me rotacion. Me ndryshimin e ligjit zgjedhor do të duhej të eliminohej edhe dobësitë e tjera që po i shohim tani. Deri më tani ne i kemi organizuar shtatë palë zgjedhje. Këto dëshmojnë se ne kemi një traditë të mirë për organizimin e zgjedhjeve. Këto do të na ndihmojnë të përmirësohemi në këtë drejtim. E vjedhja brenda llojit duhet të eliminohet. Komisionarët janë alfa dhe omega e procesit zgjedhor. Dhe, siç dihet, në procedurat e përzgjedhjes së komisionarëve nuk ka asnjë kriter që i disiplinon apo i obligon ata që gjatë procesit zgjedhor të jenë shumë të vëmendshëm dhe të mos e bëjnë bartjen e votave në mënyrë të paligjshme nga një kandidat te tjetri. Si pasojë e këtij ligji, mbi 10 për qind e votave janë të pavlefshme. Dobësi tjetër e këtij ligji është përcaktimi i Kosovës si një zonë zgjedhore. Pastaj, pse një qytetar duhet t'i votojë pesë kandidatë për deputetë. Reforma

zgjedhore, po ashtu, duhet ta përfshijë spastrimin listave, sepse te ne ende "votojnë" të vdekurit.

**"Epoka e re":** Do të ishte mirë që komisionarët të ishin jopolitikë?

**Maloku:** Komisionarët tani i zgjedhin partitë. Vetë fakti se ata i zgjedhin partitë, komisionarët mund të jenë njerëz që janë të gatshëm të veprojnë jo në mënyrë të drejtë. Sa kam qenë anëtar i KQZ-së kam njohur njerëz që kanë qenë në gjendje të korruptohen. Do të ishte mirë që të ndryshohet kjo mënyrë e përzgjedhjes së komisionarëve. Ata duhet të përgatiten për këtë çështje nëpërmjet projekteve edukative, ose të forcohen masat ligjore për ata që përpiqen ta devijojnë vullnetin e qytetarëve

**"Epoka e re":** Meqenëse deformimi po ndodh gjatë numërimit të votave për kandidatët, çfarë duhet të bëjmë që të eliminohet kjo?

**Maloku:** Edhe kjo çështje duhet të ndryshohet. Gjithashtu, duhet të heqim dorë nga numërimi fizik i fletëvotimeve, sepse gjatë këtyre proceseve ekziston mundësia edhe prishjes së fletëvotimeve në mënyrë të qëllimshme. Duhet të shikohet mundësia e numërimit elektronik të votave.

**"Epoka e re":** Janë bërë shumë kërkesa nga kandidatët për deputetë dhe parti politike për rinumërim të përgjithshëm të votave. A duhet të rinumërohen?

**Maloku:** U takon institucioneve për menaxhimin e zgjedhjeve të vlerësojnë nëse ka bazë për rinumërim të përgjithshëm në nivel vendi, kurse partive politike u takon të ankohen nëse kanë prova për këtë çështje. Di që rinumërimi do ta zgjaste shumë këtë proces. Nëse ndodh kjo, me siguri se ky proces do të zgjaste edhe një muaj.

të ndryshohet kjo mënyrë e përzgjedhjes së komisionarëve. Ata duhet të përgatiten për këtë çështje përmes projekteve edukative, ose të forcohen masat ligjore për ata që mundohen ta devijojnë vull-

netin e qytetarëve", ka thënë Maloku. Gjithashtu, ai i ka ftuar institucionet e ardhshme që të centralizohet numërimi i votave për kandidatët për deputetë. "Numërimi i votave për kandidatë nuk duhet të

## Komandanti i FSK-së mori pjesë në konferencën e shefave të Mbrojtjes në Gjermani

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, mori pjesë në Konferencën e 27 vjetore të shefave të Mbrojtjes, e cila u mbajt në Wiesbaden të Gjermanisë nga data 23-25 tetor 2019. Në këtë konferencë morën pjesë mbi 37 shefa të mbrojtjes të shteteve evropiane, anëtarë të NATO-s dhe shtete partnere të Kosovës.

Konferenca e Shefave të Mbrojtjes u organizua nga

Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe kishte për tematikë "Gatishmërinë strategjike", në kontekst të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së gatishmërisë kolektive bazuar në sfidat aktuale të sigurisë në botë. Po ashtu, temë e kësaj konference ishte edhe ndërveprimi ndërmjet shteteve anëtare të NATO-s si dhe aftësia për t'u adaptuar ndaj sfidave të sigurisë.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë konferencës zhvilloi

takime me shefin e Shtabit të Ushtrisë Amerikane, gjeneralin James McConville dhe komandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Christopher Cavoli, si dhe me homologët të shumtë të shteteve mike.

Komandanti i FSK-së, ndër të tjera, në këtë konferencë ka thënë: "FSK-ja mbetet e përkushtuar për ndërtimin e aftësive të reja mbrojtëse sipas planit të tranzicionit, në mbështetje të plotë të part-



nerëve strategjike, si dhe mbetet e përkushtuar për zhvillimin e kapaciteteve në të gjitha fushat


me qëllim të ndërveprimit me partnerët strategjikë dhe me shtetet e tjera partnere".

# GLPS-ja: Ekspertiza në rastin Dehari, dëshmi që shteti i Kosovës i shkeli atij të drejtën në jetë dhe gjykim të drejtë

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) i konsideron serioze të gjeturat e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë sa iu përket rrethanave të humbjes së jetës së Astrit Dehari, ish-aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje. "Fakti që institucionet e Kosovës nxituan të nxirrnin konkluzione që janë plotësisht në shpërputhje me të gjeturat e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë është tejet shqetësuese dhe rast për hetim të thellë jo vetëm të rrethanave të vdekjes së Astrit Deharit, por edhe të vet prokurorëve, policëve e zyrtarëve të tjerë shtetërorë të Republikës sonë që me kaq shumë lehtësi e cilësuan rastin si vetëvrasje. Dëshirojmë të theksojmë se të gjeturat e Institutit të Mjekësisë Ligjore janë dëshmi që shteti i Kosovës i shkeli Astrit Deharit të drejtën në jetë, duke mos i dhënë mbrojtje minimale në kohën sa ai mbahej në paraburgim", është thënë në reagimin e GLPS-së. "Arsyeja e mbajtjes së tij në paraburgim, e cila shoqërohet me faktin se ai ishte aktivist i një

partie politike në opozitë, e shton edhe më shumë përgjegjësinë e shtetit në raport me pasojën e prodhuar. Gjithashtu, dështimi i organeve të ndjekjes penale dhe nxitimi i tyre në cilësimin e rastit, është tregues i një papërgjegjësie dhe qëllimi kriminal. Asgjë më shumë sesa një e vërtetë e vlefshme me fakte të mjekësisë ligjore nuk i duhej publikut dhe familjes Dehari, por mënyra si veproi Prokurori i Shtetit dhe njësitë e tjera shtetërore e demonstuan pikërisht të kundërtën".

GLPS-ja kërkon që rrethi i hetimit të kësaj çështjeje të zgjerohet, duke përfshirë të gjithë zyrtarët shtetërorë (përfshirë prokurorë, policë dhe mjekë ligjorë) të cilët kontribuuan në cilësimin e rastit dhe nxjerrjen e një konkluzioni hetimor që sot del të ketë qenë i pambështetur në fakte e prova shkencore e kriminalistike. "Vetëm sjellja para drejtësisë e tërë zinxhirit që e sollën këtë situatë mund ta sanojë pasojën e krijuar. Thirrjet për hetim të rastit nga shtete të huaja nuk



duhen të shërbejnë si metodë për heqje të përgjegjësisë, përkundrazi është koha që me asistencën e huaj prokurorët vendorë të jenë ata që i dalin ballë krimit që ka ndodhur në këtë rast", është thënë në këtë reagim.

GLPS-ja, gjithashtu, konsideron se gjykatat në Kosovë duhet ta

përcaktojnë përgjegjësinë shtetërore në rastin Dehari, duke gjetur prokurorinë e shtetit, sistemin gjyqësor dhe organet e tjera të përgjegjshme për shkeljen e të drejtës në jetë të Astritit, që garantohet me Nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. "Neglizhenca e qëllimshme ose e paqëllimshme

e organeve ekzekutive në raport me këtë rast, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, duhet sjell para drejtësisë, gjithashtu. Kosova nuk mund të lejojë që rastet e vrasjeve të konkludohen si vetëvrasje dhe që kjo të bëhet përmes një sistemi të organizuar prokurorial e shtetëror", është theksuar në reagimin e GLPS-së.

## Mbahen aktivitete policore kundër dhunës në familje

MITROVICË, 25 TETOR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë, me qëllim të vetëdijesimit dhe parandalimit, ka filluar zbatimin e projektit 'Dhuna në familje'. Gjatë muajit tetor po mbahen ligjërata me nxënës të shkollave fillore me temë 'Dhuna në familje', ku kryesisht janë përfshirë nxënës të klasave të nënta.

Gjatë kësaj kohe ligjëratat i kanë dëgjuar rreth 460 nxënës të 14 shkollave të ndryshme në rajonin e Mitrovicës. Këto ligjërata janë mbajtur nga zyrtarë policorë të fushës përkatëse, ku nxënësve u është ligjëruar për dhunën në familje si dukuri mjaft specifike, meqë ndodh brenda familjes, andaj është e domosdoshme të

trajtohet në mënyrë të veçantë dhe me profesionalizëm nga të gjithë. Masat dhe përkushtimi i vazhdueshëm që po ndërmer Policia me mekanizmat e tjerë institucionalë për parandalimin e dukurisë së rasteve me elemente të dhunës në familje reflektojnë seriozitetin dhe qasjen aktive në lëmin e parandalimit.



## Prishtina bëhet me monitorë për publikimin e të dhënave të cilësisë së ajrit

PRISHTINË, 25 TETOR (ER)

- Në Sheshin "Nënë Tereza" në Prishtinë të premten është mbajtur ceremonia e dorëzimit të monitorëve për publikimin e të dhënave të cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka thënë se shpërndarja e monitorëve po bëhet për ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për rëndësinë e ajrit të pastër. Ai ka pohuar se monitorët do t'i njoftojnë qytetarët për cilësinë e ajrit në kohë reale. Sipas Matoshit, ky projekt kap vlerën mbi katër milionë euro.

Ndërkaq përfaqësuesi i Zyrës së



JICA-s për Ballkan, Jiro Takeichi, ka thënë se Japonia ka mbështetur Kosovën për zhvillimin kapaciteteve në këtë sektor. Siç tha ai, këta monitorë do të shfrytëzohen për edukimin e gjeneratës së re.

## Mjeku nga Australia do t'i operojë 25 fëmijë me probleme kirurgjike

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Mjeku i njohur australian Paddy Dewan po qëndron këtu ditë në Kosovë dhe me asistimin e kirurgëve të vendit tonë është duke kryer intervenime te fëmi-

jët me probleme të lindura në Kirurgjinë Pediatrike. Sipas planit operativ, deri në fundjavë pritet të operohen 25 fëmijë pa pasur nevojë për trajtim jashtë vendit të cilët do t'i

kushtonin shtrenjtë buxhetit të shtetit.

Dewan ka qëndruar në Prishtinë për të dymbëdhjetën herë dhe në mënyrë vullnetare ka kryer operacione në QKUK,

nga të cilat kanë përfituar fëmijët e Kosovës, por edhe kirurgët pediatrikë që kanë pasur mundësinë të mësojnë rreth aplikimit të metodave të fundit kirurgjike.



## Vëzhguesit e BE-së thonë se procesi zgjedhor ishte në përputhje të standardeve demokratike

PRISHTINË, 25 TETOR - Nënkrjetarja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, e shoqëruar nga anëtarët e kryesisë, Doruntinë Maloku dhe Florian Dushi, kanë pritur të premten në takim përfaqësuesit e Misionit Vëzhgues të Bashkimit Evropian (BE) me të cilët kanë biseduar për procesin e zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit. Përfaqësuesit e Misionit Vëzhgues të BE-së janë njoftuar nga nënkryetarja Osmani lidhur me fushatën, procesin e zgjedhjeve të 6 tetorit si dhe me numërimin e rezultateve që po vazhdon ende. Me këtë rast, të dyja palët kanë vlerësuar se procesi është zhvilluar konform standardeve demokratike. Sipas komunikatës për medie të LDK-së, udhëheqësi i delegacionit të Misionit Vëzhgues të BE-

së, Dominic Howell, ka potencuar rëndësinë e këtij procesi dhe ka vlerësuar mbarëvajtjen e tij. Po ashtu, gjatë ditës së premtë nënkryetarja Osmani është takuar edhe me Ulrika Richardson, koordinatore për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP), me të cilën ka diskutuar për situatën aktuale, prioritetet dhe thellimin e bashkëpunimit me UNDP.

Osmani është takuar edhe me ambasadorin e Republikës së Çekisë në Kosovë, Pavel Bilek, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike në vend si dhe për qëndrimet e prioritetet e LDK-së në të ardhmen.

Po në këtë takim është biseduar edhe për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve.



## Kurti: Prioritetet e qeverisë së re, zhvillimi ekonomik dhe luftimi i korrupsionit



PRISHTINË, 25 TETOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, së bashku me anëtarin e kryesisë, Xhelal Sveçla, të premten ka pritur në takim anëtarin e Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP), Fikrim Damka. Sipas njoftimit për medie të Vetëvendosjes, Kurti dhe Damka kanë biseduar për mbarëvajtjen dhe për rezultatit e zgjedhjeve, për planet e qeverisë së re dhe për mundësitë e një bashkëpunimi për shtetndërtim demokratik.

Kurti në këtë takim ka bërë me dije se zhvillimi ekonomik dhe luftimi i korrupsionit do të jenë prioritetet e qeverisë së re. Po ashtu, ai ka bërë me dije se qeveria e re do t'i trajtojë të gjithë

qytetarët e Republikës barabar dhe do të punojë për zhvillimin dhe integrimin e të gjitha pakicave kombëtare në vend pa bërë dallime. "Kryetari Kurti e njoftoi z. Damka se prioritetet e qeverisë së re do të jenë: zhvillimi ekonomik që sjell punësim, luftimi i korrupsionit të lartë dhe politikat që zbusin pabarazinë në shoqëri. Kurti e siguroi se qeveria e re do t'i trajtojë të gjithë qytetarët e Republikës të barabartë dhe do të punojë për zhvillimin dhe integrimin e të gjitha pakicave kombëtare në vend, pa bërë dallime. Në fund të takimit u shpreh gatishmëria për ta shtuar komunikimin dhe bashkëpunimin mes nesh në të ardhmen", është thënë në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje.

## Nis fushata vetëdijesuese për uljen e aksidenteve fatale në komunikacion

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 TETOR - Shoqata e Sigurimeve e Kosovës, Policia e Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës, në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, kanë nisur edhe zyrtarisht fushatën trejavëshe vetëdijesuese që për qëllim të vetëm ka uljen e aksidenteve me pasoja fatale. Në takimin i cili është mbajtur sot në këtë universitet kanë marrë pjesë shumë studentë, përfaqësues nga policia e Kosovës, por edhe zyrtarë të lartë të institucioneve të vendit.

Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, ka thënë se Shoqata e Sigurimeve e Kosovës gjatë 12 muajve të vitit

organizon aktivitete të shumta që për qëllim të vetëm e kanë rritjen e sigurisë në komunikacion. Ai ka treguar se së bashku me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës dhe ata të Ministrisë së Infrastrukturës fushatën do ta nisnin në Universitetin Publik të Gjiilanit, duke vazhduar kështu në të gjitha universitetet publike në gjithë Kosovën, por edhe në kolegje private e institucione të tjera. Sipas tij, çdo ditë e më shumë si pasojë e fushatave intensive sensibilizuese është duke u rritur vetëdija e qytetarëve, prandaj edhe kemi më pak aksidente me pasoja fatale.

Shoqata e Sigurimeve e Kosovës përfaqëson të gjitha kompanitë e sigurimeve që janë të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.



# Bardhyl Mahmuti i shkruan letër publike Mats Malmit, sekretar i Akademisë Suedeze



Sekretari i Akademisë Suedeze, Mats Malm, ka deklaruar se "në shkrimet e Peter Handkes Akademia nuk ka gjetur asgjë që përbën një sulm ndaj shoqërisë civile ose mosrespektim të barazisë mes njerëzve" dhe "nëse zbulohet diçka e re për Handken, ne do ta rivlerësojmë".

Në letrën publike, e cila, e përkthyer në gjuhën suedeze, i është dërguar edhe në adresën e tij (Mats Malm) të e-mailit, politologu Bardhyl Mahmuti i ka numëruar një sërë argumentesh që dëshmojnë në mënyrë bindëse se në veprat e veta Peter Handke është mishëruar tërësisht me ideologjinë nacionaliste serbe dhe shpreh urrejtje kundër shqiptarëve, muslimanëve dhe kujtdo qoftë tjetër që kundërshton projektet e kësaj ideologjie.

Bardhyl Mahmuti shpreson se deri më 9 dhjetor, datë kur ndahet çmimi Nobel, Akademisë Suedeze do t'i ofrohen dëshmi të mjaftueshme për ta rishikuar vendimin e vet ndaj Peter Handke.

## Letra e plotë e politologut Bardhyl Mahmuti:

*Inderuar z. Malm,*

Në shkrimin e publikuar më 17 tetor në gazetën "Dagens Nyheter", të titulluar "Mats Malm: Nëse zbulohet diçka e re për Handken ne do ta rivlerësojmë", thuhet se "në shkrimet e Peter Handkes Akademia nuk ka gjetur asgjë që përbën një sulm ndaj shoqërisë civile ose mosrespektim të barazisë mes njerëzve".

Premtimi juaj, se do ta rishikoni vendimin në rast se "zbulohet diçka e re për Handken...", që do të dëshmonte të kundërtën e asaj që dini ju për laureatin e çmimit Nobel në letërsi për vitin 2019, më shtyu t'ju drejtohem publikisht nëpërmjet kësaj letrë.

Do të përmend vetëm disa argumente të mbështetura në veprën "artistike" të shkrimtarit Peter Handke, që dëshmojnë se, kur bëhet fjalë për projektet ideologjike serbe me të cilat mishërohet tërësisht autori në fjalë, atëherë respekti i barazisë ndërmjet njerëzve nuk është qasje e huaj për shkrimtarin Peter Handke. Në këto projekte ai mishërohet me tërë qenien e vet dhe sulmon në mënyrë të papërmbytur këdo që merr guximin ta rrezikojë realizimin e atyre projekteve.

Në këtë letër publike do të kufizohem vetëm në veprën "Die Kuckuckevon Velika Hoza" (Qyqet e Hoçës së Madhe), sepse më duket e mjaftueshme për të dëshmuar se në shkrimet e Peter Handkes Akademia Suedeze mund gjejë shumëllojshmëri që përbën një sulm ndaj

shoqërisë civile ose mosrespektimin e barazisë mes njerëzve. (Të gjitha citatat e mëposhtme janë marrë nga përkthimi frëngjisht i kësaj vepre: "Lescoucou de Velika Hoza", botuar nga "La Différence", Paris, 2011).

Në fillim të kësaj vepre, Peter Handke tregon se kishte vendosur që, për festën e Pashkës ortodokse të vitit 2008, ta vizitonte "Kosovën serbe".

Përkufizimi i Kosovës si "Kosovë serbe" dëshmon për identifikimin e Peter Handkes me interpretimin ideologjik të historisë. Ky qëndrim i tij është shtrembërim i realitetit historik dhe sulm i drejtpërdrejtë ndaj shqiptarëve. Të gjithë ata që kanë njohuri për historinë, e dinë fare mirë se shqiptarët janë banorë autoktonë të kësaj pjesë të Evropës dhe se historia e Kosovës nuk fillon me ardhjen e sllavëve në Ballkan. Në këtë kontekst, do të citoj historianin francez, Alain Ducellier, i cili thotë: "Të gjitha punimet më të reja nga fusha e linguitikës dhe e arkeologjisë, dëshmojnë se ilirët janë, pa asnjë dyshim, paraardhësit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve. Çdokush di se sllavët janë populli indoeuropian, që ka ardhur më së voni në Evropë, sepse vala e dyndjeve të tyre shtrihet në shekullin VI dhe VII të erës sonë. Të gjitha argumentet e tipit historik për gjoja "Kosovën serbe" kthehen kundër tezës serbe, sepse historia na mëson që serbët, në raport me Kosovën, janë pushtues që kanë ardhur shumë vonë". (Alain Ducellier, "Les Albanaissent-ils des envahisseurs au Kosovo?" (A e pushtuan shqiptarët Kosovën?).

Përkundër fakteve historike, në veprën e vet "artistike" Peter Handke përvetëson tërësisht gjuhën ideologjike të nacionalizmit serb dhe këmbëngul se "Kosova është tokë serbe, ku edhe drurët e blirit janë drurë sllavë (...). E drejta serbe mbi Kosovën mbështetet në të drejtën mbi atë tokë të mbjellë me drithëra nga serbët, që qëndrojnë tani në atë tokë, bashkë me jetën dhe punën e mëparshme të prindërve, të gjyshërve, të stërgjyshërve, të katragjyshërve dhe të stërgjyshërve të katragjyshërve të tyre... Kjo e drejtë nuk ka nevojë për legjenda e, hiç më pak, për mite (...). E drejta serbe mbi Kosovën buron mbi këtë bazë dhe nuk e di se çfarë loje po luan historia, që ua ka konfiskuar Kosovën serbëve dhe, në këtë mënyrë, është bërë një padrejtësi e madhe (...)."

Përkufizimi i Kosovës si "Kosovë serbe" në librin e Peter Handkes, është shembull i trajtimit të njëanshëm të fakteve shoqërore dhe mungesë e respektit për barazinë e të gjithë njerëzve në Kosovë. Shpifjet se gjoja "shqiptarët kanë konfiskuar Kosovën" dhe se gjoja kanë "ndryshuar emërtimet e toponimeve", siç bën Peter Handke, janë sulme të drejtpërdrejta kundër shqiptarëve dhe luftënxitëse, sepse kanë për qëllim të mobilizojnë forcat ekstremiste serbe për të "çliruar Kosovën nga

shqiptarët".

Sado që dikush të përipiqet ta shohë ndaras veprën artistike të Peter Handkes nga angazhimet e tij në mbështetje të një ideologjie, që ka shkaktuar tragjedi të mëdha në Ballkan, mllefi "artistik" i këtij autori nuk meriton çmimin për letërsi, për shkak se kreativiteti i intelektualit njerëzor në fushën e letërsisë duhet t'u rezistojë ideologjive shkatërrimtare.

Përveç mllefut antishqiptar të Peter Handkes, për shkak të gjoja "konfiskimit të Kosovës serbe", për "padrejtësinë që u janë bërë serbëve", Peter Handke fajëson edhe "praninë e forcave të KFOR-it në Kosovë". Për këtë laureat të çmimit Nobel, pjesëtarët e KFOR-it janë "shpezë të çuditshme, që nuk mund të konsiderohen as si vizitorë, as si mysafirë, të cilët, para bombardimeve të NATO-s, kishin ardhur në Kosovë si ndërmjetësues, si arbitra ose thjesht si vëzhgues ndërkombëtarë...". Në penën "artistike" plot helm të Peter Handkes, pjesëtarët e kësaj force janë "njerëz pa atdhe, që kishin ardhur në Kosovën serbe për të gjetur një atdheun e tyre të ri së paku një strehë, për arsye se çdonjëri prej tyre kishte probleme ligjore në vendin e vet dhe nuk mund të kthehej atje. Janë si qyq, që kanë ardhur të bëjnë vezët në foletë e të tjerëve: në Kosovën serbe"!!!

Prezantimi i pjesëtarëve të forcave të sigurisë në Kosovë (KFOR-it) si të ishin kriminelë, që nuk mund të kthehen në vendet e tyre, të cilët kanë ardhur si qyq për të bërë vezë në Kosovën serbe, është tejet përbuzës dhe shembull i mungesës së respektit dhe i paragjyqimeve që mbretërojnë në penën e këtij laureati të çmimit Nobel. Përtej përbuzjes dhe mungesës së respektit që tregon ndaj pjesëtarëve të KFOR-it, kur i trajton si "kriminelë" dhe si "qyq", Peter Handke shpreh urrejtje të papërmbytur ndaj shqiptarëve. Për laureatin e çmimit Nobel në letërsi për vitin 2019, "shqiptarët nuk mund të krahasohen metaforikisht me asnjë kafshë. Të krahasohen shqiptarët me qyqet, është tepër e butë si metaforë". Shqiptarët janë më të

këqij se kafshët në veprën "artistike" të Peter Handkes! Për ta ilustruar se sa përbindësja janë shqiptarët, autori përmend një femër, që kishte ardhur për festën e Pashkës në Hoçë të Madhe dhe ishte prezantuar si "gazetare shqiptare e krishterë, që simpatizonte këtë enklavë. Por një javë më vonë, në gazetën "Der Spiegel" të Hamburgut, ajo kishte publikuar një shkrim jo për mënyrën si kremtohej Pashka në këtë vend, por paraqiste Hoçën e Madhe si strehë kriminelësh, kurse priftin si njeri të sferës politike...".

Çdokush që ka lexuar veprën "Qyqet e Hoçës së Madhe", ka vërtetur se me çfarë urrejtje fetare përshkruhen dy pjesët e qytetit të Mitrovicës. Në përshkrimin e pjesës veriore të Mitrovicës, Peter Handke sheh vetëm "katedrale të bukura ortodokse, ku përveç serbëve, në këtë pjesë të qytetit jetojnë edhe popuj të tjerë. Ndërkaq, në jug, sipas tij, jetojnë vetëm shqiptarët dhe mbizotërojnë kupolat e xhamive, si tenda të rrethuara me minare si raketa... ku duhet të jesh i kujdesshëm të mos shqiptosh ndonjë fjalë në gjuhën serbe, të mos dukesh kureshtar dhe të mos prezantohesh si "écrivain", "writer", "shkrimtar" ose "poet", sepse do të ngjalle dyshim te shqiptarët, të cilët tolerojnë vetëm gazetarët...".

Prezantimi i pjesës jugore të Mitrovicës si vend, ku gjoja jetojnë vetëm shqiptarët dhe fshheja e faktit se në këtë vend jetojnë edhe boshnjakë, romë, ashkali dhe turq, është tendencioz, për të arsyetuar pretendimin e propagandës ideologjike serbe, për gjoja "konfiskimin e Kosovës serbe nga shqiptarët". Nuk mund të ketë mungesë më të madhe respekti për barazinë e të gjithë njerëzve, sesa mohimi që i bën Peter Handke ekzistencës së boshnjakëve, romëve, ashkalinjve dhe turqve në pjesën jugore të qytetit të Mitrovicës. Shqiptarët, serbët, boshnjakët, malazezët, ashkalinjt, egjiptianët, turqit janë gjithandëj ku kanë qenë edhe më parë, dhe përfaqësohen në të gjitha institucionet shtetërore të Kosovës. Është problem i Peter Handkes, që

ka përqafuar pa asnjë rezervë ideologjinë e nacionalizmit serb dhe që pretendon se aty ku nuk ka serbë është tokë e askujt, një "noman's-land", që e përmend aq shpesh.

Për të ngjallur urrejtjen kundër shqiptarëve, në "Qyqet e Hoçës së Madhe" ai shpif se gjoja "një serb me probleme në veshkë, i cili duhet të bënte dializë dhe të trajtohej çdo javë në spitalin e Prizrenit, është përballur me fyerje nga shqiptarët". Për të qenë më bindës në rrefimin e vet, autori sajton një mjeke me origjinë turke, që ishte treguar shumë e sjellshme me këtë serb, e paskësh trajtuar si pacientët e tjerë dhe e gjithë kjo për arsye se turqit kanë mësuar të sillen si zotërinj, kurse shqiptarët kurrë nuk mund të sillen si zotërinj".

Në përshkrimin e festës së Pashkës ortodokse në Hoçë të Madhe, kjo vepër e Peter Handkes arrin kulmin e urrejtjes religjioze dhe etnike. Sipas përshkrimit "artistik" të këtij autori, "sapo filluan të binin kampanat e kishës, u dëgjua njëkohësisht zëri kumbues i myezinit të fshatit shqiptar, që ishte afër fshatit Hoçë e Madhe, i cili bënte thirrje për faljen e orës 11, si dhe lehjet e qenve endacakë"!!! Shqiptarët e përkatësisë religjioze islame dhe qentë endacakë ua prishën banorëve të Hoçës së Madhe festimin e Pashkës!

Një gënjeshtër e tillë mund të përhapet vetëm nga mendjet e robëruara prej ideologjisë së ngarkuar me urrejtje etnike dhe religjioze. Edhe pse është i vetëdijshëm, se falja e drekës në asnjë rast nuk bëhet në orën 11, Peter Handke gënjen qëllimisht, për të krijuar përshtypjen se kleri musliman ndryshon edhe orën e kohës së faljes, vetëm e vetëm për të penguar festën e krishterë! Mungon vetëm akuza e koordinimit me qentë endacakë, për t'u bërë edhe një të padrejtë serbëve në Kosovë!

*Inderuar z. Malm,*

Mund të vazhdoj me shembuj të shumtë dhe të arrijmë tek i njëjti rezultat: vepra e Peter Handkes ka më shumë nxitje të urrejtjes religjioze dhe ndëretnike sesa art të mirëfilltë. Si e tillë, autori i këtyre veprave nuk e meriton të jetë laureat i çmimit Nobel për letërsi, sepse do të përligjte përbuzjet, talljet dhe fyerjet që u bëhen viktimave të ideologjisë së nacionalizmit serb, të "ambalazhuara me stofin artistik" të Peter Handkes.

**P. s.**

Në vitin 2014 Peter Handke fitoi Çmimin Ndërkombëtar "Henrik Ibsen". Shumën prej 50 mijë eurosh ua dërgoi banorëve serbë të Hoçës së Madhe në Kosovë.

Nuk duhet të habitet askush, në rast se Peter Handke ua dhuron forcave ekstremiste serbe vlerën monetare të çmimit Nobel, për ta "çliruar Kosovën nga konfiskimi shqiptar".

Me respekt,  
Bardhyl Mahmuti,  
politolog Zvicër





# Të bërit biznes, mes lehtësive ligjore dhe burokracisë institucionale

PRISHTINË, 25 TETOR - Ambienti afarist i të bërit biznes në Kosovë ende ballafaqohet me sfida dhe probleme të ndryshme, me gjithë përmirësimet e vogla që janë bërë, thonë pronarë të bizneseve dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit.

Burim Pirraj, pronar i industrisë së mishit "Meka", në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se vetëm regjistrimi i një biznesi të ri është një proces i lehtë për t'u realizuar, kurse mbijetesja e biznesit në fazat e zhvillimit, sipas tij, kalon nëpër sfida të shumta.

Problem kryesor për të bërit biznes Pirraj e konsideron burokracinë në institucionet kompetente. "Burokracia është shumë e theksuar. Ka probleme burokratike. Nëpër institucione ka njerëz të punësuar pa kualifikim adekuat të cilët shkaktojnë probleme", ka thënë ai. Sipas tij, këto probleme nuk i shohin institucionet, por për afaristët paraqesin sfida në punën e tyre. "Megjithatë, ka pak përmirësim, por ende nuk ka politika fiskale të favorshme për biznesin vendor", ka theksuar Pirraj.


Edhe përfaqësues të biznesit theksojnë se burokracia, korrup-

sioni dhe mungesa e sundimit të ligjit po e dëmtojnë mjedisin biznesor, njëherësh po pengojnë ardhjen e investitorëve të huaj.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se klima biznesore është vështirësuar nga taksa të ndryshme dhe kjo, sipas tij, ka bërë që Kosova të mos jetë vend atraktiv për investitorët e brendshëm dhe ata ndërkombëtarë.

"Vetëm vitin e kaluar 50 milionë euro ka qenë vlera e investime të huaja, ka rreth 12 mijë të punësuar më pak. Kjo tregon se klima biznesore është vështirësuar, është ngarkuar me taksa, me burokraci të licencave, leje të ndërtimit dhe të gjitha këto kanë bërë që Kosova mos të jetë atraktive për investimet e huaja dhe investitorët të gjejnë më lehtë vend për investime në shtetet e tjera", ka bërë me dije Shahini.

Bazuar në raportin e publikuar të Bankës Botërore, "Të bërit biznes" për vitin 2020, Kosova vlerësohet se ka shënuar rënie krahasuar me një vit më parë. Në këtë raport, Banka Botërore e rendit Kosovën në pozitën e 57, përkatësisht 13 pozita më poshtë, nga viti i kaluar ku radhitej në vendin e 44-t nga gjithsej



190 shtete sa janë të përfshira në këtë raport. Pavarësisht kësaj, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në komunikatën për media ka thënë se raporti i Bankës Botërore konfirmon përpunimin gradual dhe të qëndrueshëm të Kosovës drejt krijimit të një klime të favorshme për biznes dhe tërheqje të investimeve në vend.

Përpunimi i bërë nga Kosova, thuhet në komunikatë, është i pashëm nga analizimi i të dhë-

nave nga raporti që tregon se Kosova ka shënuar përmirësim në lehtësinë e të bërit biznes dhe ka pasur përparim në shtatë indikatorë nga 10 sa janë gjithsej. "Në të, mes të tjerash, thuhet se Kosova e ka bërë më të lehtë menaxhimin e lejeve të ndërtimit, ka përmirësuar furnizimin me energji elektrike, ka forcuar mbrojtjen e investitorëve të pakicave dhe ka lehtësuar zbatimin e kontratave", thuhet në komunikatë dhe në raportin

e Bankës Botërore.

Në raportin e Bankës Botërore Kosova paraqitet e katërta nga vendet e rajonit. Ajo renditet pas Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi, kurse Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina radhiten më poshtë. Përveç kësaj, në raportin e Bankës Botërore "theksohet se Azerbajxhani, Kirgizia, Kosova dhe Uzbekistani dolën ndër 20 ekonomitë më të përmirësuara në mbarë botën".

## Veterinarët mësojnë metodat bashkëkohore të mirëqenies së kafshëve të shoqërimit



PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Organizata KSAVA (organizatë veterinarë që merret me kafshët), Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve, me mbështetje të Odës së Veterinarëve të Kosovës (OVK) dhe Agjencisë së Ushqimit e Veterinarisë (AUV), organizuan seminarin e parë për kafshë të shoqërimit me temën "Mirëqenia e kafshëve të shoqërimit".

Presidenti i KSAVA, mjeku veterinar Dardan Pozhegu, ka treguar qëllimin e këtij seminari. "Qëllimi i këtij seminari është që doktorët që përfshihen në projektin e menaxhimit dhe trajtimit të qenve endacakë të informohen me metodat më bashkëkohore gjatë këtij procesi", ka thënë Pozhegu. Ai ka pohuar se pjesë e

këtij procesi janë edhe identifikimi, regjistrimi, monitorimi i qenve endacakë në vend, gjithashtu pjesë e rëndësishme është roli i veterinarëve në menaxhimin e duhur të popullatës së qenve endacak.

E kryetari i OVK-së, Arben Sinani, u shpreh i kënaqur me temën e seminarit, sidomos me interesimin e kolegëve veterinarë. "Seminare të tilla do të organizohen edhe në vazhdimësi. Temat të shumtën e herëve do të varen nga nevoja e veterinarëve të terrenit", ka dekluar Sinani.

Edhe pjesëmarrësit aty u shprehën të kënaqur me temën e seminarit, duke kërkuar që seminarët të vazhdojnë edhe më. Në fund të trajnimit pjesëmarrësit pajisen me certifikata.

## Vazhdon aksioni për largimin e kioskave pa leje në Mitrovicë

MITROVICË, 25 TETOR (ER) - Me kërkesë të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm të Komunës së Mitrovicës inspektorët komunalë kanë ndërmarë aksion për largimin e dy kioskave, të vendosura buzë lumit Ibër, të cilat operonin pa leje adekuate nga autoritetet komunale. Me këtë rast

Drejtorja e Inspeksionit i është përgjigjur kësaj kërkesë, pasi pronarët e kioskave nuk i kanë kryer obligimet ligjore ndaj Komunës së Mitrovicës dhe kanë shfrytëzuar kioskat edhe pas skadimit të afatit të paraparë të kontratës. Ky aksion është zhvilluar edhe me asistencë të Policisë së Kosovës,

duke ndihmuar për lirimin e hapësirave publike dhe për krijimin e kushteve për qarkullim të lirë të qytetarëve.

Drejtorja e Inspeksionit ka bërë me dije se aksione të këtilla do të vazhdojnë deri në eliminimin e tërësishëm të kësaj dukurie në mënyrë që të lirohen hapësirat e uzurpuara komunale.



# ËSHTË NDRYSHE, NUK ËSHTË SI JU!



Shkruan: **Bedri ISLAMI**

44-vjeçari, i cili pritet ta marrë mandatin nga presidenti i Kosovës, për ta formuar qeverinë e re të saj, është Albin Kurti. Fituesi i zgjedhjeve të 6 tetorit, politikanin më i votuar në të dytën herë radhazi, ka kohën e tij për të bërë gjithçka që do të jetë në dobi të shtetit të tij, të cilin herë e ka njohur e herë jo, por që, në mënyrën më të fuqishme të mundur, ka qenë opozitar me një ngrehinë pushtetore që kishte pritur 6 tetorin për të shkuar në shembjen e saj. Nuk është e rëndësishme se sa për qind votuan për vizionin e paraqitur nga ai dhe forca politike që drejton. E rëndësishme është se në të gjithë këtë pasiguri politike që ishte krijuar dhe që, si mendohet, do të thellohet më tej përmes Tribunalit Special, ai ishte i vetmi ku mund të besohej dhe, me gjithë figurën e Vjosa Osmanit, në krahun tjetër të politikës, me të cilën do të bashkëpunojnë, ai përfaqëson të vetmen forcë politike në Kosovë, e cila, deri tani, nuk është provuar dhe të vetmin lider politik, emri i të cilit nuk është lidhur me pushtetin dhe aferat e tij. Tani koha është e tij dhe vitet që e presin mund të sjellin në qendrën e pushtetit një njeri, tek i cili, si ndodh në politikë, shumë besojnë se do të sjellë një erë të re e, po ashtu, të tjerë që presin padurimshëm bjerrjen e kësaj shprese.

Në Tiranë fitorja e Kurtit, opozitar në të gjitha legjislaturat, ka ngjallur idenë se e njëjta gjë do të ndodhë edhe në Shqipëri, pasi koha e opozitës për të qenë në pushtet ka një shembull dhe, sipas tij, duhen bërë edhe rotacioni politik. Mediat pranë opozitës e shohin këtë si gjysmën e rrugës së tyre, por ngjashmëritë mes Albin Kurtit dhe liderëve tanë janë aq të pakta sa janë edhe ndryshimet.

Albin Kurti është një politikan i lexuar, që një më shumë se çdo lider tjetër rrymat dhe filozofitë politike, që ndjek ecuritë e tyre edhe në ditët e sotme dhe që, edhe në çaste të vështira, ka pasur synimin e tij drejt rrjedhës së mendimit politik, filozofik dhe kulturor. Opozitarët në Shqipëri, të cilët kohët e fundit ai i ka takuar dhe me të cilët do të zhgënjehet shumë shpejt, janë, në fakt, e kundërta e njeriut që do ta drejtojë Qeverinë e Kosovës. Përgjithësisht njerëz që janë hasmëruar me librin, të cilët, pasi kanë mësuar disa slogane, qëndrojnë në drejtimin e partive ose të komanduar nga shefat e mëparshëm, ose partitë e tyre janë partiçka, të cilat, së bashku, nuk kanë votues për një grusht autobusësh.

Albin Kurti vjen në qeverisjen e vendit pas 22 vjetësh jetë politike. As nuk ia bëri kush dhuratë, si Lulzim Bashës, as nuk ia la bashkëshortja, si Monika Kryemadhut, as nuk ndërtoi një parti hije. Albin Kurti nuk doli një mesnatë nga zyrat e Ramiz Alisë, me porosinë e krijimit të një partie opozitare, as nuk e gjeti të gatshme si Nano, ku militantët janë më të devotshëm sesa liderët, as nuk e krijoi nga zemërimi i ndarjes si ishte fillesa e LSI-së, as nuk e ka të falur si Basha, e as parti të qokave, si janë tani me shumicë në Shqipëri. Për të shkuar drejt pushtetit bëri 22 vjet rrugë nga përballja e parë me politikën. Në këtë rrugë kishte edhe qasje të nxituara, edhe çaste shpërthimi, largime e afrime. Do të ketë edhe në të ardhmen ndodhi të tilla sepse, si çdo gjë tjetër, në forcat politike pulson e drejta dhe ngutja e gabimi, njerëz të kënaqur me vizionin dhe të inatosur me të, por atë që e ngriti e bëri mundimshëm, herë-herë me forcë dhe më shpesh përmes filozofisë së tij politike, e cila, edhe pse duket si e së majtës, në fakt është një e majtë e qendrës, që lë shteg për bashkëpunim me të gjitha forcat politike.

Në ndërtimin e kësaj force politike ai kishte rreth vetes mjaft prej figurave të reja politike, të cilat kishin një fillesë të shkëlqyer

atdhetare në trugun e tyre familjar, si Glauk Konjufca, Liburn Aliu, Albulena Haxhiu e shumë të rinj të tjerë, që u formuan si njerëz të politikës nga rruga që bënë, por përkushtimin e kishin që në fillësë.

Albin Kurti bën pjesë në trupën drejtuese të Lëvizjes Studentore të vitit 1997. Një katërshe drejtuese, ku shqueshin Muhamet Mavraj, Bujar Dugolli, Dritan Lajçi, Albin Kurti, së bashku me rektorin e Universitetit të Prishtinës, profesorin e shquar dhe atdhetarin e jashtëzakonshëm Ejup Statovci, do të jenë në ballë të demonstruesve. Të katërt kishin të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre, por që të katërt, pjesë të një lëvizje klandestine, do të jenë më pas në rradhë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në protestën masive ndodh edhe përplasja e parë, çka do të thotë pagëzimi i parë me politikën e ashpër. Mendoni tani liderët e opozitës: Basha erdhi në pushtet pa e ditur ende mirë se cilës parti i takon. Ia falën dhe manipuluan gjithçka që falja të ishte e ligjshme. Më shpejt erdhi në pushtet sesa mësoi se çfarë është forca politike që e zgjodhi, pas rekomandimit të familjes kryeministore. Ndërsa krahasimi me liderët të tjerë, Ndoka, Mejdiu, Shehu, Duka, që Berisha e quante dikur "Duka i krimi", do të ishte i turpshëm.

Opozita në Shqipëri, edhe kur ka qenë në pushtet, edhe tani, kë pasur jo vetëm prirjen, por qëllimin e përfuturit dhe, të gjithë, deri te Dule, dhjaku i dikurshëm i lobit grek në Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare, janë sot ndër njerëzit më të pasur. Pronarë vilash dhe pjesë e resorteve para të cilave blloku i dikurshëm duket si lagje e varfër, me lidhje të fuqishme oligarkie, herë-herë edhe pjesë e rrjeteve kriminale, ndërtues të strukturave të mëdha të kultivimit të drogës, në fund të fundit, të gjithë të provuar dhe të gjithë të rrëzuar.

Ardhja në pushtet e opozitës në Shqipëri nuk do të bënte asgjë tjetër, veçse ndërrimin e kalit që tërheq qerren e pushtetit, por destinacioni i qerres do të ishte i

njëjtë ashtu si dhe ka ndodhur. Me gjithë kalkulimet e mbrapshta politike e financiare të Edi Ramës, riardhja e opozitës, e kësaj opozite, nuk do të ishte asgjë tjetër veçse rifillim i lojës së vjetër.

Kurti besohet se do të sjellë frymë të re, të cilën as nuk e kanë dhe as kanë ndër mend ta gjejnë. Disa nga format e përdorura nga Lëvizja Vetëvendosje kanë qenë të ngjashme me ato që u përsëritën nga opozita e tashme. Por, ndërsa në Prishtinë ata kishin tragizmin e tyre, në Shqipëri kishin komedinë. Nëse atje bëhej fjalë për çështje që lidhen me gjithë kombin dhe të ardhmen e tij, si demarkacioni, që solli humbje të territorit shqiptar, Asociacioni i Komunave Serbe, që sjell rindarje të Kosovës, krijimi i Gjykatës Speciale, që akuzon një luftë çlirimtare dhe amnistion krimin serb në Kosovë, në Shqipëri ata ishin tragjikomike, ata mbronin me çdo kusht një kryeprokuror që më pas do të jetë në listën e zezë të Departamentit të Shtetit, hidhnin çizme dhe ishin çizme të shtrenjta, rrëmbenin kartonët e votimit të deputetëve, krijonin skena plagosje, çupëlinat e parlamentit vetëshpallëshin si Shotë Galica dhe e gjitha për të ruajtur një korrupsion që e kishte futur në sirtar një shef prokurorie dhe që nuk i nxjerr dot as e tashmja.

Në Kuvendin e Kosovës kishte hedhje të gazit tymues, por edhe demaskime të pushtetit, kishte braktisje të seancave, por jo të Kuvendit, kishte denoncime të zgjedhjeve, por jo largim prej tyre. Nëse Albin Kurti do të kishte ikur nga Kuvendi dhe nuk do të futej në zgjedhje, ta zëmë, se nuk e do Hashim Thaçin president, dhe nuk e do vërtetë, e kjo është një luftë e shpallur që nga ditët e Rambujesë. Pra, nëse do të strukej në zyrat e partisë, të shpejtonte në darkë për të pasur orën e supës, të banonte në dy kate të tëra bashke me familjen vjeprrore; të bënte deklarata budallaqe si ato të Palokës, pra të ikte nga përballja, LV-ja do të shkonte drejt shuarjes dhe dëshira kryeministore do të strukej në sirtarë.

Natyrisht, as ai nuk është imun ndaj mendimit ndryshe dhe, një

lider i duhur e pranon këtë mendim. Pa mendimin ndryshe asnjë forcë politike nuk mund të jetë e hapur, evropiane, e vërtetë dhe moderne. Kurti duhet ta pranojë këtë ashtu si duhet të ketë qartësim të saktë, pa ekuivok dhe serioz ndaj rritjes së ekstremizmit islamik, dukuri që po zë gjithnjë e më shumë hapësirë edhe në politikën shqiptare.

Dua të besoj se qeveritari i parë i Kosovës, që pas disa ditësh do të jetë në zyrën e tij, do ta perceptojë vizionin e tij ndryshe nga qeveria e tashme në Shqipëri. Në fakt, në dy anët e kufirit të përbashkët kemi dy shefa qeverie që e përdorin fjalën si pakkush dhe kanë egon e tyre politike si pak të tjerë. Janë të gatshëm të përballen, por edhe ta shtrijnë dorën, gjithnjë nëse i pari, Rama, e sheh çështjen e Kosovës edhe përmes syrit të Prishtinës dhe, i dyti, Kurti, e krijon hapësirën politike për të pasur pjesë të atij vizioni që ka shfaqur dikur ndaj shtetit shqiptar, si pjesa më vitale e kombit.

Është koha kur të gjithë do të përpiqen të përfitojnë nga statura e re e shefit të qeverisë së ardhshme të Kosovës dhe, më pas, dikush do të zhgënjehet dhe do ta fillojë agresivitetin ndaj tij, e dikush do të lehtësohet.

Do të sulen të përfitojnë arrivistët, në Prishtinë dhe në Tiranë, të mençurit, në dy anët e kufirit, politikanët e rinj që aspirojnë një vend në sofrën e politikës dhe të vjetrit që nuk shkulen nga kjo sofër; do të ketë përpjekje për ta bërë si veten dhe për të ngritur një statujë fitimtare.

Në fakt, të gjithë, edhe analistët në Shqipëri, edhe përkrahësit e tashëm të Kurtit, që ishin deri para pak muajve kundërshtarët e denigruesit e tij, duhet t'i dinë dy gjëra: në Kosovë nuk ka ndodhur asnjë mrekulli e jashtëzakonshme. Ka ndodhur një ndryshim, të cilin, shefi i ardhshëm i qeverisë e ka në dorë, ose ta kthejë në një mrekulli të shumëpritur, ose të bjerë në batakun e humbjes së shpresës.

Dhe e dyta, është koha të kuptojnë se ai, Kurti, është ndryshe, nuk është si ju, megjithëse të gjithë do të përpiqen ta bëjnë njërin nga ata.

## A PO RRËSHQASIM DREJT NJË KATASTROFE TË RE



Milazim KRASNIQI

1. Raporti për Astrit Deharin u jep më shumë argument atyre që kanë dyshuar dhe që sot dyshojnë

edhe më shumë se ai është vrarë në burg. Ky zbulim ka mundësi t'i rritë edhe më shumë emocionet, tensionet dhe urrejtjet politike në vend.

2. Intervistimet nga Gjykata Speciale po i afrohen kulmimit me arrestime, gjë që sigurisht se do t'i rritë emocionet dhe tensionet dhe do ta vë në prova të rënda shtetin tonë.

3. Ndërrhyrja e Serbisë në procesin zgjedhor në Kosovë, jo vetëm me

Listën Serpska, po edhe me vota të kontrabanduara, mund ta shtojë destabilitetin.

4. Tendencat okulte për ta penguar formimin e shpejtë të qeverisë së re, me zhargitjen e certifikimit të rezultateve, mund t'i rrisin tensionet edhe më shumë.

5. Krahas këtyre çështjeve tronditëse, mbeten endemike varfëria, papunësia, izolimi, korrupsioni, injoranca dhe urrejtja.

Me një fjalë, janë probleme që janë grumbulluar si pasojë e paaftësisë, po edhe e mosdashjes së institucioneve shtetërore për t'i zgjidhur problemet. Tash kur këto probleme kanë dalë në sipërfaqe, ka rrezik se mund të ndërliken dhe të shkaktojnë reagime të pakontrolluara. Prandaj, sot dhe tash duhet të jetë e ditur për institucionet, për partitë dhe për mbarë shoqërinë tonë, se evitimi i një katastrofe të re mund të bëhet vetëm me menaxhimin e këtyre

problemeve me konsensus, duke adresuar përgjegjësitë e abuzuesve dhe duke krijuar shpejt institucionet e reja. Nëse vazhdon paraliza e institucioneve shtetërore dhe konflikti politik, nëse këto çështje përdoren për qërim politik të hesapeve, mund të ballafaqohemi me një katastrofë të re, e cila, bashkë me shoqërinë tonë moralisht të ndotur, do ta plandosë edhe shtetin tonë rekonvalescent.

# ME QEVERI TË RE, SHPEJT E SIGURT, DREJT BE-SË

Proceset euro-integruese do të jenë sfidat e radhës të qeverisë së re, kurse klasa politike, përfshirë edhe opozitën, duhet ta ngrehë në një shkallë shumë më të lartë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e ideve dhe veprimeve që do t'i jepnin Kosovës vendin e merituar në familjen e madhe evropiane



**Nga Mehmet PRISHTINA**

Një prej arsyeve se pse duhet shpejtuar për formimin Qeverisë së re të Kosovës është zënia e hapave të humbur në proceset eurointegruese që ndodhën si pasojë e disa faktorëve e rrethanave si të natyrës parimore të vet BE-së, por edhe të projekteve të gabuara politike të krerëve politikë të Prishtinës.

Në Kosovë zgjedhjet e 6 tetorit për herë të parë pas njëzetë vjetëve ndryshuan kahun e zhvillimeve politike, duke ofruar mundësinë e një politikëbërje ndryshe si për nga dinamika e përgjegjësive, po ashtu edhe për nga pastërtia e

vendimmarrjes.

Nuk ka më kurrfarë arsye objektive të vonohet formimi i qeverisë së re sepse çdo ditë e humbur është humbje për gjithë procesin që pritet të jetë i vështirë e kompleks. Kosovën në të ardhmen e presin beteja politike në dy plane: në planin e jashtëm duhet ta rrumbullakojë çështjen e hapur me Serbinë, duke imponuar një partneritet serioz në tryezat e bisedimeve që do të mbikëqyren nga Uashingtoni dhe Brukseli dhe, në planin e brendshëm, ku dy partitë fituese, LV-ja dhe LDK-ja, gjatë fushatës zgjedhore kishin piketuar disa shtylla mjaft të rëndësishme mbi të cilat duhet të mbështetet qeverisja e ardhshme, e që duhet të fillojë nga sundimi i ligjit e deri të krijimi i klimës së shëndoshë për investime të huaja e të brendshme. Nëse procesi zgjedhor pati një mbarëvajtje të përkryer, i konfirmuar edhe nga shumë

vëzhgues e media të huaja, tanimë nuk ka kurrfarë arsye që ky proces të deformohet në tavolinë, siç ka tendenca e përpjekje për t'i zgjuar nga 'nokdauni' zgjedhor disa subjekte politike, në favor të një inxhinjeringu të panatyrshëm elektoral që do ta pamundësonte krijimin e koalicionit qeveritar nga LV dhe LDK (!)

Kosova nuk e ka luksin të projekteve fitore që nuk janë vullnete popullore të konfirmuara në zgjedhje. LV-ja dhe LDK-ja janë në rrugë të mirë që të ideojnë në praktikë një partneritet solid bashkëqeverisës i cili do t'i jepte vendit jo vetëm strategjinë e daljes nga kjo situatë e palakueshme, por edhe një standard të ri në kulturën e këtushme politike, duke favorizuar idetë e përbashkëta për punë dhe vizion. Ky koalicion bashkëqeverisës mund të jetë garanci edhe për mbarëvajtjen e proceseve eurointegruese, kurse Kosova e ka shansin të bëjë hapa më të shpejtë në sajë të mësimin prej gabimeve të të tjerëve në rajon. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk morën dritë jeshile nga Këshilli i Evropës për datën e negociatave me BE-në, ngjarje kjo mjaft deprimuese për qytetarët e këtyre vendeve, por në anën tjetër një Kosovë e organizuar dhe e strukturuar mirë në planin e reformave institucionale dhe betejave antikorrupsive, lehtësisht

mund ta nxitë kureshtjen e diplomatëve në Bruksel për një aktivizim më të shpejtë të reflektorëve mbi proceset e ardhshme në Kosovë.

Integrimi i vonuar i Kosovës në BE nuk është me pasojë vetëm për qytetarët e saj, por për gjithë rajonin. Nisma e fundit e Serbisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për formimin e të ashtuquajturit 'Mini Shengeni Ballkanik' mund të jetë kurthi i radhës që i kurdiset Kosovës, duke e larguar atë nga proceset vendimmarrëse në Ballkan, në njërin anë, por edhe duke e prezantuar atë të padenjë në aspektin e ndërtimit të subjektivitetit shtetëror, në anën tjetër. Ngutia për të formuar këtë nismë ballkanike mund të jetë me pasojë jo të pakta sa i përket komunikimit Kosovë - Shqipëri për arsye se Tirana zyrtare edhe formalisht me këtë nismë është zotuar se bashkëpunimin rajonal do ta bëjë duke e anashkaluar Kosovën. Nuk e kemi të qartë se si do të funksionojë në praktikë ky 'Mini Shengen', kur fare mirë dihet se zbatimi në praktikë i tij implikon edhe çështje territoriale që lidhen me Kosovën.

Me fjalë të tjera, çfarë komunikimi dhe bashkëpunimi mund të ketë në mes të Serbisë dhe Shqipërisë, nëse nuk merret parasysh sovraniteti dhe integriteti i shtetit të

Kosovës, pavarësia e të cilit ka krijuar tash më realitete gjeopolitike në rajon. Pa Kosovën jo vetëm është i pamundur ky komunikim dhe bashkëpunim, por tingëllon edhe paradoksale sepse në shikim të parë proklamoni lirinë lëvizjes, kurse në anën tjetër mohon shtetësinë e Kosovës.

Një qeveri dinjitoze dhe kompetente që pritet të formohet do të jetë 'terapia' më e adekuate ndaj gjithë këtyre anomalive që po i imponohen shtetit të Kosovës. LV-ja dhe LDK-ja është sintheza më kuptimplotë e një filozofie të re politike e cila Kosovën do ta largonte nga bataku i inferioritetit të deritanishëm dhe do ta shpinte në 'klubin e të barabartëve', ku vendimmarrja nuk është e imponuar dhe as e paracaktimit të obligimeve. Serbia ka borxhe, kurse Kosova nuk ka obligime. Kosova ka vetëm përgjegjësi ndaj brezave të ardhshëm që në vitet në vazhdim të mos ketë plagë të hapura në marrëdhëniet me fqinjët.

Proceset euro-integruese do të jenë sfidat e radhës së qeverisë së re, kurse klasa politike, përfshirë edhe opozitën, duhet ta ngrehë në një shkallë shumë më të lartë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e ideve dhe të veprimeve që do t'ia jepnin Kosovës vendin e merituar në familjen e madhe evropiane.

## Nxënësit e Dragashit trajnohen për promovimin e aktiviteteve në natyrë

Dragash, 25 tetor (ER) - Drejtorja e Arsimit në Dragash dhe Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë organizojnë trajnimin dyditor në kuadër të projektit "Gjithëpërfshirja sociale përmes aktiviteteve në natyrë" me nxënësit të shkollës së mesme "Ruzhdi Berisha" në Dragash.

Ky projekt implementohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në bashkëpunim me Klubin Alpin Prishtina (KAP). Projekti synon të promovojë aktivitete në natyrë që do ta përmirësojnë të kuptuarit e diversitetit kulturor midis të rinjve në Kosovë dhe të angazhojnë studentët me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore për të marrë pjesë në aktivitete në natyrë së bashku. "Projekti ka për qëllim zhvillimin e një platforme afatg-



jatë për arsimin në natyrë në Kosovë, duke hartuar një manual për trajnerë të cilët punojnë me të rinj për aktivitetet në natyrë. Pjesëmarrësit do ta kenë rastin që për dy ditë me radhë të trajnohen nga trajnerë të licencuar për

fushat specifike të sporteve në natyrë (bjeshkatari, orientim, alpinizëm, skijim dhe ndihmën e parë). Trajnimi dyditor do të mbahet në Qendrën Rinore të Gërmisë", ka njoftuar Komuna e Dragashit.

## Prindërit pajisin me dollapë shkollën 'Fehmi Agani' në Turjakë të Malishevës

Malishevë, 25 tetor

(ER) - Me vetiniciativën e komunitetit prindëror në Malishevë është realizuar projekti për vendosjen e dollapëve për të gjithë nxënësit e nivelit filor, përkatësisht klasave I deri të V-ta. Pajisja e klasave me dollapë personale për nxënësit e grupmoshave 6-11 vjeçar, sipas prindërve, ishte shumë e nevojshme. Për shkak të aftësive fizike të nxënësve në raport me peshën e papërbalueshme të çantave të stërngarkuara me libra, vendosjen që t'i ndihmojnë fëmijët e tyre, ku që nga premtja ata me



vete do t'i kenë vetëm librat sipas orarit mësimor, për t'u përgatitur për mësim. Realizimin e këtij projekti me rëndësi për nxënësit e shkollës e mundësuan prindërit, mobileria "Doni" në Mirushë, veçanërisht Kastriot R. Kastriati, i cili jeton dhe vepron në Zvicër.

## Në Jagodë të Klinës vazhdojnë punimet për ndërtimin e kanalit për ujitje

KLINË, 25 TETOR (ER) - Në fshatin Jagodë të Komunës së Klinës janë duke vazhduar punimet për ndërtimin e kanalit për ujitje. Për ta parë nga afër ecurinë e punimeve,

i pranishëm ishte edhe drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Naser Morina. Me këtë rast, ai ka thënë se investimet e tilla janë të domosdoshme për

zhvillimin e bujqësisë në komunën tonë. Sipas drejtorit Morina, ujitja e fushës së këtij fshati kontribuon për rritjen e rendimenteve dhe stabilizimin e prodhimit të

bimëve. Ndërsa këto projekte kanë avantazh sigurimin e prodhimit të lartë dhe të cilësisë, pavarësisht prej kushteve klimatike të vitit si dhe cilësinë e prodhimit.



## BE-ja pajtohet për shtyrje të Brexit-it

**BRUKSEL, 25 TETOR** - Ambasadorët e Bashkimit Evropian u pajtuan për shtyrje të Brexit-it, apo të daljes së Britanisë nga BE-ja, por nuk do të vendosin për datën e saktë deri javën e ardhshme. Zëdhënësja e BE-së, Mina Andreeva, tha se puna për këtë çështje do të vazhdojë në ditët në vijim. Bisedimet u zhvilluan pasi kancelari britanik, Sajid Javid, pranoi se afati i 31 tetorit për Brexit-in nuk mund të përm-

bushet. Ligjvënësit britanikë pritet të shqyrtojnë të hënën thirrjen e kryeministrit të tyre, Boris Johnson, për zgjedhje të parakohshme. Johnsoni tha se do të donte t'i mbante zgjedhjet e përgjithshme më 12 dhjetor, nëse BE-ja e shtyn Brexit-in deri më 31 janar. Britania ka vendosur të largohet nga BE-ja në një referendum të mbajtur në vitin 2016. Që atëherë vazhdojnë edhe

negociatat për një marrëveshje mbi kushtet e divorcimit. Palët kanë arritur dy marrëveshje, por asnjëra nuk ka gjetur mbështetje të mjaftueshme në Parlamentin britanik. Kundërshtimet kanë të bëjnë kryesisht me politikat që do të zbatohen në kufirin me Irlandën, pas Brexit-it. Britania është paralajmëruar për pasoja të rënda ekonomike nëse e lë BE-në pa marrëveshje. Kjo është shtyrja e tretë e afatit për Brexit.



## Raporti i Muellerit, cak i hetimeve penale

Prokurori i Përgjithshëm amerikan, William Barr ka nisur një rishikim të hetimeve më herët gjatë vitit, pas ankesave që ka bërë presidenti amerikan, Donald Trump se fushata e tij është shënjestruar gabimisht nga inteligjenca amerikane dhe agjencitë për zbatim të ligjit në zgjedhjet e vitit 2016



**WASHINGTON, 25 TETOR** - Rishikimi i hetimeve rreth ndërhyrjes ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara nga Departamenti amerikan i Shtetit, tani ka kaluar në fazën e hetimeve penale, kanë raportuar mediet amerikane. Një person që ka folur në kushte anonimiteti për agjencinë e lajmeve Reuters, ka mohuar të deklarojë nëse është krijuar ndonjë juri e madhe për këto hetime, ka njoftuar rfe. Raportimet e para rreth kësaj çështjeje janë parë në të përditshmen amerikane, "The New York Times". Prokurori i Përgjithshëm amerikan, William Barr ka nisur një rishikim të hetimeve më herët gjatë vitit, pas ankesave që ka bërë presidenti amerikan, Donald Trump se fushata e tij është shënjestruar gabimisht nga inteligjenca amerikane dhe agjencitë për zbatim të ligjit në zgjedhjet e vitit 2016. Demokratët dhe disa ish-zyrtarë për zbatim të ligjit kanë thënë se Barr është duke shfrytëzuar Departamentin e

Drejtësisë për të ndjekur teori konspirative pa substancë, nga të cilat mund të përfitojë politikisht presidenti republikan si dhe të dëmtohen hetimet e kryera për Rusinë nga këshilltari special, Robert Mueller. Në kuadër të hetimeve të tij, Barr u ka kërkuar ndihmë zyrtarëve britanikë dhe atyre australianë të drejtësisë, si dhe ka vizituar dy herë Romën, për takime me agjentë të inteligjencës, në mënyrë që të mësojë më shumë për njerëzit e përmendur në raportin e Muellerit. Hetimet e Muellerit patën gjetur se Moska ka ndërhyrë në zgjedhjet e vitit 2016 në të mirë të Trumpit, çka ka rezultuar me ngritje të padive penale për disa ish-ndihmës të fushatës së presidentit. Mirëpo Mueller ka thënë se nuk ka pasur të dhëna të mjaftueshme për të prezantuar komplot kriminal për Rusinë. Barr ka emëruar prokurorin, John Durham për të udhëhequr rishikimin e hetimeve, rreth asaj nëse agjenci amerikane të inteligjencës apo ato për zbatim të ligjit kanë vepruar në për-

puthje me ligjin kur kanë hetuar lidhjet e mundshme në mes të fushatës së Trumpit dhe Rusisë, veprime të cilat më pas kanë rezultuar me hetimet e Muellerit. Në prill, Barr u pati thënë anëtarëve të Kongresit se beson që në fushatën e Trumpit më 2016 ka ndodhur një "spionim". "Pyetja është nëse është planifikuar në mënyrë adekuate. Nuk po them se ka qenë në mënyrë jo të duhur. Mirëpo më duhej ta hetoj atë", tha ai. Trump i cili i cilëson hetimet rreth Rusisë si "gjueti shtrigash" dhe mashtrim, ka thënë se zyr-

tarët amerikanë kanë nisur hetimet për të dëmtuar atë në fitoren e pozitës së presidentit në Shtëpinë e Bardhë, pavarësisht pse ai dhe mbështetësit e tij nuk ofrojnë të dhëna për këto pretendime. Aktualisht Trumpi është duke u përballur edhe me një hetim tjetër të demokratëve për shkarkim të tij, pasi një informator ka treguar detaje rreth bisedës së presidentit amerikan me homologun e tij ukrainas, Volodymyr Zelenskiy më 25 korrik, në të cilin Zeleskiy i kërkohet të kryejë hetime për ish nën-presidentin amerikan,


Joe Biden dhe djalin e tij Hunter. Hetimet e Dhomës së Përfaqësuesve mund të rezultojnë me gjykim në Senat rreth asaj nëse Trumpi duhet të largohet nga zyra e presidentit. Sipas Kushtetutës amerikane, Dhoma e Përfaqësuesve ka fuqi për të shkarkuar presidentin për "shkelje të rënda dhe keqgjyryje". Kjo është hera e katërt në historinë amerikane që ka nisur një procedurë për shkarkim të presidentit, ndonëse asnjëri prej presidentëve nuk është larguar nga pozita përmes këtij procesi.

## Rusia dërgon qindra ushtarë në kufirin Siri-Turqi

**MOSKË, 25 TETOR** - Rusia tha se rreth 300 pjesëtarë të Policisë së saj ushtarake kanë arritur në Siri, për të patrulluar në zonën kufitare me Turqinë. Ky veprim pason një marrëveshje midis Moskës dhe Ankarasë për dëbimin e kurdëve nga zona. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha se Policia ushtarake ka arritur atje nga Çeçenia, ndërsa janë transferuar edhe mbi 20 autom-

jete të blinduara nga rajonet Rostov dhe Krasnodar, në bazën ruse në perëndim të Sirisë. Marrëveshja Turqi-Rusi ka pasuar një marrëveshje tjetër midis Turqisë dhe ShBA-së. Me këtë të fundit, Turqia e ka ndaluar ofensivën ndaj forcave kurde përgjatë kufirit të saj, e cila ka zgjatur tetë ditë dhe ka lënë qindra njerëz të vrarë. Turqia është pajtuar për armëpushim, për t'u mundësuar

kurdëve të ikin rreth 30 kilometra larg kufirit. Ajo i konsideron milicët kurde në Siri si "terroriste", edhe pse ato kanë qenë aleate të ngushta të ShBA-së në luftën kundër militantëve të Shtetit Islamik. Presidenti amerikan, Donald Trump, ka vendosur t'i tërheqë trupat amerikane nga Siria, ndërsa të enjten ka thënë se do të mbajë një prani të vogël atje për të mbrojtur fushat e naftës.





## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

E rrallë

## Turistët nxitojnë të ngjiten në shkëmbin e shenjtë Uluru para mbylljes së përhershme

Turma të mëdha të njerëzve kanë nisur ngjitjen në Uluru të Australisë në ditën e fundit para se të ndalohej ky aktivitet. Uluru konsiderohet vend i shenjtë për banorët indigjenë, Anangu, të cilët u kanë kërkuar një kohë të gjatë turistëve të mos ngjiten. Vetëm 16 për qind e vizitorëve janë ngjitur në këtë shkëmb në vitin 2017, kur edhe është njoftuar për ndalimin, mirëpo ky aktivitet është shpeshuar javët e fundit.



FOTO E DITES



Një burrë shikon një stuhi mbi detin Mesdhe në qytetin francez Riviera të Nices. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Rrezaku, polici i vogël i Gjakovës që jep gjoba 50 centësh

Një nëntëvjeçar nga Gjakova po kryen punën e policit për t'i parandaluar shkeljet në trafik. Rrezak Kinolli këtë e ka pasion dhe tash e disa ditë po e ushtron në lagjen e vet. Për moshën e tij ka sjellje goxha profesionale. Pasi kontrollon



dokumentet, ai shqipton edhe gjobat për shkelësit e rregullave të komunikacionit.

## BARSOLETA E DITËS



Anija ndalon në një port dhe të gjithë marinarët vërshojnë në tokë, përpos njërit. Kapiteni e pyet:  
- Po ti, s'ke një grua në këtë port?  
- Kam, si s'kam, por është gruaja ime.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

## ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

## TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

## MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

## ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.

 <p><b>DASHI</b> Pjesa juaj e jashtme dhe ajo e brendshme nuk do të jenë të sinkronizuara gjatë ditës së sotme për të lindurit e kësaj shenje.</p>	 <p><b>DEMI</b> Mos flisni rreth gjërave tuaja private dhe përgjithësisht përpiquni t'i mbani të fshehta ato.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Do të ndiheni shumë energjik gjatë ditës së sotme dhe të mbushur me optimizëm.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Ekziston mundësia të mendoni sikur askush nuk po ju kupton.</p>	 <p><b>LUANI</b> Të lindurit e kësaj shenje do të sillen me diplomaci gjatë ditës së sotme.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Energjia pozitive e të tjerëve do të ndikojë mjaft mirë edhe te ju sot.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Një detyrim familjar do të shkaktojë një konflikt mes jush dhe partnerit/partneres suaj.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sapo të zgjoheni në mëngjes do ta ndieni energjinë e duhur për të ndërmarrë disa sfida të ndryshme.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Mund të përbaleni me një situatë tejet të vështirë gjatë kësaj të premteje, por do ta përballoni me qetësi.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Nuk ka rëndësi se çfarë do të bëni sot, por rëndësi ka ta bëni atë me bindje.</p>	 <p><b>UJORI</b> Nëse jeni të interesuar të njihni dikë më mirë, mos dëgjoni fjalët që thuhën për të, por shihni me vëmendje veprimet e tij/saj.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Nëse një i afërmi juaj po sillet krejt ndryshe sot, përpiquni të zbuloni se çfarë po ndodh me të.</p>

## Charlie Puth thotë se ka qenë dy herë duke vdekur gjatë turit të koncerteve



**K**ëngëtari i njohur Charlie Puth ka thënë se dy herë ka qenë duke vdekur gjatë turit të tij të koncerteve. Puth këtë e tha në një intervistë të premtën për emisionin Lorraine në ITV.

"Unë u sëmura shumë në turne sepse nuk dija si të isha artist. Unë pothuajse vdiq dy herë. Ishte vërtet e vështirë. Unë u sëmura për një vit, tani e di se si ta vazhdoj", ka deklaruar Puth.

## Pas martesës, Nicki Minaj do dasmë të madhe



**N**donëse martesë e Nicki Minajt dhe Kenneth "Zoo" Libonzi ishte shumë private, çifti planifikon në të ardhmen një dasmë të madhe për familjen dhe miqtë. Çifti e ka kurorëzuar dashurinë e tyre më 21 tetor në një rezidencë private në Los

Anxhelos, derisa "TMZ" kishte raportuar se i pranishëm, pos nuses dhe dhëndrit, ishte vetëm pastori. Sipas disa burimeve të afërta, ndonëse çiftit nuk po i ngutet për dasmën e tyre, ata me siguri se duan ta bëjnë një dasmë të madhe.



## Rihanna shkëlqeu në ditëlindjen e Drake

**R**ihanna dhe Drake, të cilët ishin në lidhje në vitin 2016, u ribashkuan në festën e ditëlindjes së reperit të hënën në

zonën e Los Anxhelosit. Sipas "Daily Mail", këngëtarja dukej shumë bukur pasi kishte të veshur një komplet ngjyrë ari dhe me shkëlqim.

## Pete Davidson shihet duke dalë nga banesa e supermodelueses Kaia Gerber



**P**ete Davidson, që së fundmi është sërish beqar, është parë duke u larguar nga apartamenti i supermodelueses Kaia Gerber të mërkurën. Një burim e ka konfirmuar për "Page Six" se 25-vjeçari Davidson e ka vizituar 18-vjeçaren Gerber, por ka

shtuar se ata janë vetëm miq dhe nuk ka asgjë tjetër mes tyre. Në fotografitë që paparacët kanë arritur të kapin, ylli i "Saturday Night Live" shihet i veshur me rroba sportive derisa po ecte me AirPods e vënë në vesh rrugëve të lagjes ku Gerberi jeton.

# AGIM VINCA SJELL LIBRIN ME POEZI 'ENGJËJT PËSHPËRITIN NË MËNGJES'

Prishtinë, 25 tetor (ER) - Këto ditë, në Sarajevë, në botim të shtëpisë botuese "Perfecta", doli libri me poezi i poetit Agim Vinca me titull "Engjëjt pëshpëritin në mëngjes". Recensenti i librit është shkrimtari i njohur nga Mali i Zi, Mirash Martinović, kurse redaktore profesora e Universitetit të Sarajevës dhe studiuesja e njohur Hasnija Muratagić-Tuna.

Poezitë në gjuhën boshnjake janë përkthyer nga përkthyesi Smajl Smaka (dësa nga vetë autori). Libri përmban gjithsej 65 poezi, shënimet për autorin, si dhe një poezi të poetit Husein Tahmishçiç kushtuar Agim Vincës.

Në parathënien e librit, të shkruar nga Mirash Martinović, ndër të tjera, thuhet: "Agim Vinca është poet i dorës së parë, epitete që iu përket vetëm të rrallëve - atyre në poezinë e të cilëve artikuloheh koha, historia dhe metafizika: Ajo që poetët e mëdhenj, ashtu si alkimistët, e shndërrojnë në përjetësi. Vinca është një alkimist i tillë, që përditshmërinë e shndërron në poezi të madhe. Kjo është poezi autentike, autoktone, e lidhur me truallin dhe jetën. E gjallë, si rrënjët që e thithin fuqinë nga toka. Vinca i prek telat e harfës së quajtur jetë dhe atë tingull e shndërron në fjalë, duke i dhënë kuptim çdo gjëje që prek.


Poezia e Vincës është eliptike, e pjekur deri në thelb, e ngjeshur deri në klithmë, deri në dhimbje, deri tek ai vrushkull drite që

ndriçon honet e thella. Poezia e Agim Vincës, veçanërisht ajo e shkruar në kohën e luftës dhe të torturës, sikur nuk është shkruar në letër, por në lëkurë, me gjak, me lëngun më të shtrenjtë në pergamenën më të shtrenjtë, që i jep asaj forcë e qëndrueshmëri, vulë që nuk fshihet dot.

Botimi i këtij libri e nderon letërsinë boshnjake dhe ngre një hark-urë që lidh si ylber popujt që jetojnë në Bosnjë dhe në Kosovë. Duke kaluar nëpër ferrin e luftës dhe të vuajtjeve, kjo poezi, sikurse edhe Bosnja dhe Kosova, arrin majat më të larta morale - metafora të ngritura në qiellin e njerëzisë.

Evropa dhe bota do ta njohin një ditë madhështinë e poezisë shqipe, në vetë majën e së cilës është Agim Vinca dhe poezia e tij".

Ndërsa redaktorja e librit, profesora Muratagić-Tuna, shkruan: "Në jetën e tij, sidomos në kohën e mynxyrës së madhe, Agim Vinca nuk heshti si qyqar, por ngriti zërin dhe luftoi përmes armës së tij të vetme, këngës, ashtu siç bën tani me poezitë të cilat na i ofron. Ato në asnjë çast nuk të lënë gjakftohtë, sepse ky poet me poezitë e tij na tërheq ngadalë në greminën e tmerreve të përjetuara për çdo ditë në vendin e tij ose edhe më larg, dëshmitarë të të cilave kemi qenë vetë ne. Përmbledhja e Agim Vincës është plotësisht origjinale dhe arrin të nxisë përjetim të njëmendët artistik. Tematikisht ajo është e llojlo-



jshme, përplot të dhëna për jetën dhe reflektime të këtij autori për kohën dhe hapësirën në të cilën jeton. Temat më të shpeshta janë ato të aktualitetit. Vokacionin e tij poetik e ndërton mbi tema të ndryshme. Poeti Vinca lundron përmes qenies dhe kohës së tij, prandaj një

numër i madh i poezive mund të kuptohet si dokument dhe ilustrim i një kohe të rëndë për popullin shqiptar. Çfarëdo që prek, e përpunon dhe i jep formën e perlave të vërteta artistike dhe ua dhuron lexuesve. Prandaj, këtë poezi e karakterizon shpeshherë prania e fabulës.

Lënda e ashpër motivore vishet me shprehje lirike. Kjo është poezi e përvojës, e pleksur me një sensibilitet specifik. I pajisur me dhuntinë e energjisë shpirtërore, mendimore dhe ndenjore, Vinca e shndërron çastin në përjetësi. Ai është një dukuri e veçantë në poezi përgjithësisht, poet me njohje fascinuese të rrethanave dhe të njerëzve me të cilët jeton. Në mënyrë të shkëlqyeshme, në formë imazhesh impulsive, ndërton diskursin e vet poetik. Këto poezi pashmangshëm e angazhojnë lexuesin në planin emocional dhe intelektual. Mendimi i tij është i thellë dhe universal. Secila poezi e tij është njësoj e bukur dhe e papërsëritshme. Në to fjalët kanë domethënie më të madhe se ç'është ajo që shënojnë. Agim Vinca është shumë emotiv, lirik dhe refleksiv. Ka krijuar poezi me potencial të madh asociativ. Prej tyre rrezatojnë kuptime dhe domethënie të shumta. Në to derdhen vrushkuj fjalësh, figurash, sendesh. Prandaj, mund të interpretohen pakufishëm në mënyra të ndryshme. Fjala e këtij poeti duhet të dëgjohet larg, sepse ajo sjell porosi dhe mesazhe të fuqishme. Kjo poezi fisnikëron dhe u jep përgjigje pyetjeve të mëdha të përditshmërisë. Ajo ndihmon që të kuptojmë saktësisht se cili soj njerëzor i takojmë. Poeti Agim Vinca bën thirrje për vetëdijesim dhe zhdehje, për dinjitet dhe njerëzillëk".

## PËRURORHET LIBRI PËR UÇK-në

PRISHTINË, 25 TETOR - Në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Pogdani" të premtën është përruar libri i autorit Kemajl Shaqiri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe lufta e Kosovës", libër ky i cili nga folësit është konsideruar thesar për historinë shqiptare. Redaktori i librit, Bedri Tahiri, ka theksuar se me qëllim që ky libër të bëhet i pranueshëm për lexuesit, e ka ndarë atë në pesë kapituj. Sipas Tahirit, libri i autorit Kemajl Shaqiri ka material të bollshëm që tregon për UÇK-në dhe luftën e saj kundër forcave serbe në Kosovë.

Recensenti i librit "Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe lufta e Kosovës", Hysen Geci, ka thënë se libri i Kemajl Shaqirit pasqyron vështirësitë e organizimit të luftës karshi armikut shekullor të Kosovës. Kurse autori i librit, Kemajl Shaqiri, ka thënë se këtë libër është përpjekur ta shkruajë sipas kronologjisë të ngjarjeve që kanë ndodhur para dhe pas luftës. Ai ka bërë me dije se këtë



libër ia ka kushtuar babait të tij të ndjerë i cili qe vrarë nga forcat serbe. "Ky libër më tepër është i shkruar në gjuhën profesionale

ushtarake, por me qartësimin e ngjarjeve nëpër etapa të ndryshme. Librin ia kam dedikuar babait tim, Ibush

Shaqiri, i vrarë më 29 mars 1999. Ky libër është shkruar me metodologjinë e parë me sy, e përjetuar shpirtërisht dhe e

shkruar në letër. Po të vazhdoja të shkruaja, libri do të dilte 3 000 faqe", ka thënë autori i librit, Kemajl Shaqiri.



# Tërbohen në Beograd për bilbordet me figurën e Rita Orës

“Skandaloze! Shqiptarja Rita Ora i qesh Beogradit në fytyrë! Këngëtarja e preferuar e Haradinajt dhe Thaçit në pankartat e kryeqytetit!”, kësh-tu shkruan media serbe Informer e indinjuar me këngëtarën nga Kosova me famë botërore.

Serbët e quajnë skandaloze faktin se nëpër tabelat reklamuese të Beogradit shfaqet këngëtarja Shqiptare me famë botërore Rita Ora duke promovuar një markë perëndimore stolish të çmuara.

Gazeta serbe Informer e quan Rita Orën mbështetëse të UÇK-së që ka bërë thirrje për Shqipërinë e madhe. Kjo gazetë madje ka realizuar një sërë intervistash më të rinj në kryeqytetin serb ku i pyet ata sesi ndihen që Rita Ora shfaqet në qendër të Beogradit.

“Kjo është e tmerrshme dhe është një dëshmi e nivelit të ulët të vetëdijes kombëtare të serbëve. Vendi ynë nuk duhet të lejojë një këngëtare shqiptare që mbështet krim-

inelët e UÇK-së dhe bën thirrje për krijimin e një ‘Shqipërie të Madhe’ në tabela në të gjithë kryeqytetin. Ligji urgjentisht duhet të hartohet dhe miratohet për të ndaluar publikimin e reklamave me përmbajtje anti-serbe. Ka shumë njerëz në vendin tonë që janë të gatshëm të punojnë kundër interesave të njerëzve të tyre për hir të përfitimit material”, thekson një i ri serb i intervistuar nga gazeta Serbe Informer.

“Nëse do të pyesja veten në jetë, nuk do të lejoja që një reklamë e tillë të shfaqej në vendin tonë, veçanërisht jo në kryeqytetin tonë. Dhe kjo vjen nga një grua që ka një qëndrim të qartë politik kundër Serbisë. Unë mendoj se këto tabela janë të panevojshme dhe duhet të hiqen, të paktën nga aty ku janë”, thekson Stanimiroviq, një i ri serb.

Sipas tij, këngëtarët serbë as nuk dëgjohen në Prishtinë apo Tiranë. Nebojsa Kërstiq, një ekspert i mirënjohur i mar-



ketingut në Serbi, i thotë gazetës Informer se gjëra të tilla nuk mund të ndëshkohen me ligj por nga tregu.

“Nuk është e paligjshme dhe nuk mund të ndalosh një këngëtare të shfaqet në një

reklamë. Është tregu që do të thotë fjalën e tij të fundit. Nëse një kompani ka bërë një zgjedhje të dobët të markës tregtare, atëherë kjo do të ndihet në shitjen e produkteve”, shpjegoi Kërstiq.

Artistet shqiptare Rita Ora, Bebe Rexha, Dua Lipa dhe Ava Max prej kohësh janë shndërruar në imazh të firmave ndërkombëtare pas suksesit që kanë pasur në tregun e muzikës/ *BalkanWeb*

## Ku është Jezusi 450 milionë dollarësh i Da Vinçit?

Shumë pikpyetje janë ngritur mbi autencitetin e Salvator Mundi-t të Leonardo da Vinci-t për më shumë se një dekadë dhe a do të shfaqej apo jo, kjo vepër në ekspozitën e tij në Luvër? Është kjo pyetja që ka pushtuar botën e artit mbi këtë vepër të artistit të madh që u zbulua më shumë se një shekull më parë, ndërsa Luvri dje ka hapur dyert e tij për publikun.

Piktura më e shtrenjtë në botë, një pamje e Jezusit me veshjen e Rilindjes Europiane, e cila u shit në ankand në vitin 2017 për 450 milion dollarë, mendohej se do të tërhiqte turma të mëdha të njerëzish. E përshkruar si një figurë e ngjashme me pikturën e Mona Lisa-s, vepra më e famshme e Leonardo-s, thuhet se zien “nga një gjendje e jashtëzakonshme komunikuese me shikuesin”.

Ndërsa bota e artit prej javësh ishte në dilemë nëse kjo vepër do t'i ofrohej publikut, kuratorët tani pohojnë për shtypin, se Salvator Mundi nuk u shfaq në ekspozitë. Ndërsa ishin plot shpresë për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me vendndodhjen e pikturës së famshme javë më parë, ata konfirmojnë së fundmi se është e sigurt që vepra më e shtrenjtë e artit e shitur ndonjëherë në ankand mbetet një

vepër e humbur.

Mos shfaqja e saj do të ishte kthesa e fundit në sagën e jashtëzakonshme të një pikturë që ka tërhequr aq shumë polemika, intriga dhe debate mes kritikës. Pyetjet mbi autencitetin e veprës janë përhapur tek historianët e artit për më shumë se një dekadë e vazhdojnë ende.

Luvri megjithëkëtë mbetet në gatishmëri për të mirëpritur Salvator Mundi-n, edhe nëse ajo shfaqet gjatw kohës që ekspozita mbahet hapur, thonë kuratorët. Ndaj dhe Muzeu ka prodhuar dy katalogë për shfaqjen, një me pikturën dhe një pa atë.

Salvator Mundi, vepra e cila ka ndeshur në syrin e miliona shikuesve për pamjen e tij drithëruese dhe ndoshta më shumë për çmimin e saj apo dhe intrigën ndërkombëtare, u pa për herë të fundit në publik në fundin e vitit 2017, kur u shit në New York për një shumë mararamendëse si ajo e 450.3 milion dollarëve.

Para se të zhdukej, vepra ishte e rrethuar nga polemika të shumta ku historianët të ndryshëm arti nuk pajtoheshin lidhur me autorësinë e saj. Disa i besojnë veprës me autor Leonardo-n, ndërsa të tjerët thonë se ajo përfundoi prej dishepujve të tij. Pasi



vepra u ble në vitin 2017 nga një blerës misterioz që u përfol se ishte princi i kurorës Saudite, Mohammad bin Salman, i cili ia dhuroi Luvrit të Abu Dabit, intriga u thellua më shumë kur nuk arriti të shfaqej siç ishte planifikuar në muze, në shtator të vitit 2018.

Por kohët e fundit ka spekulime se në të vërtetë vepra gjendet në super-jahutin e Mohamed bin Salman, Princit të Kurorës së Arabisë Saudite, pikërisht atij princi i cili ishte i detyruar të

mohonte përfshirjen e tij, në vrasjen e gazetarit Jamal Khashoggi. Pronari i mëparshëm i pikturës ishte oligarku rus Dmitry Rybolovlev i cili e bleu atë më 3 maj 2013 për 127.5 milion dollarë, pas një restaurimi të konsiderueshëm.

Të gjithë e dinë se në botën e artit gjenden dy piktura të tilla aq të ngjashme me njëra –tjetrën. Të dyja me të njëjtën madhësi e të dyja në dru arë. Por tek njëra prej tyre mjekra e Jezusit spikat më dendur se në tjetrën. Ndaj

dhe polemikat vazhdojnë pa rreshtur mbi autencitetin e tyre. Salvator Mundi do duhej të shfaqej në muzeun Luvrit në Abu Dabi vitin e kaluar. Por dhe atëherë si tani, ajo nuk u gjet. Kjo vepër mund të jetë piktura më e shtrenjtë në histori, dhe ndoshta më e diskutueshme që nuk shfaqet askund. Askush nuk e di se ku është piktura e vërtetë ndërsa ka zëra të mistershëm që thonë se ajo është në konservim brenda një strukture të sigurt arti në Zvicër.

Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA & AKTORJA NË FOTO 2	ANIJATË; PJESË E BRENDSHME E NJË KISHE (shq.)	↓	UDHËHEQËS I NJË FAKULTETI MËNDESHË, TAJË	TRAJNERI HOLANDEZ ... HAN	TAKSË	ZANORE	RENS ISTVUD	MENDIMET	NGADHËNJIM NË NJË LOJË	QË I KA RËNË TË FIKËT; I .....	EPOKA ERE	1				
KËNGËTARJA DHE MODER- ATORJA NË FOTO 1	○	○	○	○	○	○	○	○	○	○	○		I ZË ME DORË				
MEKANIZËM I THJESHTË, QË SHËRMBEN PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE	○						JETË PA TRAZIME (shq.) ISH PRESIDENTI SHQIPTAR RAMIZ ....										
I UJITA	○							I MORALSHËM FUTBOLLISTI FRANCEZ TIERI ....									
ANALISTI SHQIPTAR MUSTAFA	○				I GDHENDA E THAVA												
ELIZABETH TAYLOR	○		LËNDË MËSIMORE	REGJISORI HALILI GRUMBULLIM (sh.shq.)				ZHANËR I MUZIKËS (origj.) KRYEQYTËTI I AZERBAJXH- ANI									
FUQI, FORCË	○					POLITIKANI SHQIPTAR IMAMI RIFAT AVDIU							PEIZAZHI I GJERË				
ZANORE	○	PORTIERI KASILLAS METAFORA E GJATË					INDIA, ARMENIA PJESË E KËMISHËS (sh.shq.)			ORHAN PUNAJ ZANORE			FATALIZËM	↓	AKTORJA ITALIANE BELLUÇI MOSHË E RE	TRANSFER MULTISORT ELEKTRONI	ZANORE
KALORËS JAPONEZ	○						ARKA PREJ HEKURI KU RUHEN PARA ISH ATLETI AMERIKAN MONTGOMERI										
TËRËSIA E KUSHTEVE METEOROL- OGJIKE	○					LETËR E FORTË NË BIXHOZ BASHKËTING.				I NJËZËSHËM DY BASHKË- TINGËLLORE						SEKTË I VEÇANTË I MYSLIMANËVE	
AGJENCIA EVROPIANE	○		ZANORE INDIUM, ELEKTRON		MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË INTENSITET, TITAN			KËPUCË ME RROTULLA PËR TË RRËSHQITUR HOLLË, JO TRASHË									
EPOKA ERE	KËNGËTARE E JONA GRUP MUZIKOR					EMËR MASHKULLI MYSLIMAN SHKRONJË GREKE					PJË ALKOOLIKE QË NXIRRET NGA MUSHTI I RRUSHIT KLINT ISTVUD					ZANORE EKZEMPLAR I VETËM	
AFTËSI E PAGIMIT (treg.)								BASHKËTING. FIGURË SHAHU		FORTESE AKTORI MUÇAJ					"URUGUAI" PRINCIPATË ARABE (sh.shq.)		
MURG I VETMUAR						MASË NDË- SHKIMORE (shq.) PASION PËR TU VËNË ZJARRIN OBJEKTEVE								KËNGËTARJA JONË E RE ... KOÇI OHAJO, PENSILVANIA			
NORA ISTREFI			ZANORE BASHKËTING.		PANDJESI, LIMONTI EVERTON						NUKLEAR NJËRI NGA AKUZUESIT E SOKRATIT (shq.)						
SHKRIMTARI ALIGHIERI					ISLANDA, MALTA FEMRA LUFTËTARE (mit greke.)			MARC ANTHONY E VËNGËR (sh.shq.)				GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE REGJISORI QOSJA					
														RADIUM, TON SHPEND ME QAFË TË GJATË (sh.shq.)			
					"MOLDE" BANJË ALLATURKA (vjet.)			FUTBOLLISTI FETAHU EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN (shq.)				PËRFUNDIM NË SHAH FUTBOLLISTI ARGJENTINAS JUAN SEBASTIAN				LLOJ BUKE	
								TEPSI BALTE (sh.shq.) HISTORIANI ROMAK LUKRECI							BASHKËTING. TINARI		
					MJESHTËRIA, PROFESIONI							PARA TË NËNTËS GURRA					
					MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT						PUNIM I ARËS						
					BEREQET (krah.)						KOHË BASHKËTING.				"RUANDA" BASHKËTING.		
					ANDORA	ISMET TOTO			STADIUMI I KLUBIT MILAN "... SIRO"					NDËRTESE PRANË UDHËS QË SHËRB- ENTE SI BUJTNË			



# Hurma arabie me qumësht - Kura që bën mrekulli për shëndetin

Është një ndër kurat më të lashta popullore përdorur mijëra vite më parë për t'u mbrojtur nga sëmundjet, për të mbajtur organizmin e fortë dhe mendjen e mprehtë.

Hurmat e arabisë kanë vlera të larta shëruese por të kombinuara në një kurë me qumësht fuqia e tyre në mbrojtje të shëndetit bëhet e jashtëzakonshme.

Më poshtë, do të mësoni nga AgroWeb.org një kurë të thjeshtë në përgatitje por fantastike dhe mirëbërëse për gjithë trupin dhe si ta përgatisni atë në shtëpi.

Këtë kurë mund ta përgatisni dhe ta konsumoni çdo ditë duke përfutuar maksimalisht vlera ushqyese dhe një organizëm të shëndetshëm gjithashtu.

## Përfitimet shëndetësore të kurës me hurma arabie dhe qumësht

Hurmat e arabisë përbajnë disa lloje sheqernash të cilat nuk kanë nevojë të treten pasi përthithen menjëherë nga gjaku dhe transferohen tek muskujt dhe truri duke ndihmuar ndërkohë në uljen e nivelit të kolesterolit në gjak.

Të kombinuara me qumësht, ato i japin trupit energji duke ndihmuar në mirëfunksionimin e të gjitha organeve të trupit.

Sipas studimeve të cilave i

referohet AgroWeb.org, një gotë qumësht me hurma arabie çdo ditë i dhuron trupit të gjitha vlerat ushqyese si hekur, fosfor, kalium, zink, magnez, vitaminë A,D dhe C dhe mbron organizmin nga ushqimet e dëmshme apo të pa shëndetshme.

Kjo kurë ndihmon në mbajtjen e enëve të gjakut të shëndetshme, sistemit nervor, veshkave, ndihmon konstipacionin, mbron kockat duke parandaluar dobësimin e tyre, forcon sistemin imuntar dhe ndihmon mëlçinë të pastrohet nga toksinat.

Për aneminë dhe zemrën

Sipas të dhënave të AgroWeb.org qumështi dhe hurmat e arabisë ndihmojnë organizmin të luftojë aneminë.

Kjo kurë përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ndihmon në zhblokimin e arterieve duke mbrojtur zemrën.

Hurmat e arabisë bashkë me qumështin shndërrohen në një agjent të fuqishëm kundër virozave, baktereve dhe infeksioneve ndërsa ndikojnë në forcimin e muskujve dhe kyçeve gjithashtu.

## Forcon shikimin dhe dëgjimin

Sipas të dhënave të cilave i referohet AgroWeb.org, konsumimi i qumështit me hurma arabie përmirëson nivelin e shikimit duke forcuar në tërësi shëndetin e syve.



Gjithashtu kjo kurë ndihmon në shëndetin e veshëve, forcon dëgjimin si dhe sistemin nervor në tërësi.

Redukton stresin dhe irritimet dhe dhuron qetësi shpirtërore dhe mendore.

Falë vlerave të larta ushqyese, qumështi me hurma arabie ndihmon edhe në forcimin e dhëmbëve gjithashtu.

## Përgatitja e kurës me qumësht dhe hurma arabie

Pastroni me ujë të rrjedhshëm 7 hurma arabie. Largojini bërthamën dhe pjesën e tulit pritëni në dy pjesë. Kalojini në mikser dhe më pas shtoni një gotë me qumësht. Kalojini sërish në mikser derisa masa të njëtrajtësohet. Më pas hidheni në një gotë dhe pijeni menjëherë.

Mund ta pini çdo ditë herët në

mëngjes por edhe gjatë ditës apo në mbrëmje./AgroWeb.org

\* Ky informacion ka për qëllim të plotësojë, të mos zëvendësojë këshilla nga mjeku juaj ose ofruesi i kujdesit shëndetësor dhe nuk ka për qëllim të mbulojë të gjitha përdorimet e mundshme, masat paraprake, ndërveprimet ose efektet negative. Ky informacion mund të mos i përshtatet rrethanave tuaja specifike shëndetësore.

# Shëndeti i stomakut - Cilat janë mëngjeset që duhet të hani


Mirëqenia e organizmit gjatë ditës lidhet me mënyrën e të ushqyerit në mëngjes.

Jo më kot, ekspertët nuk reshtin së vlerësuar mëngjesin si vaktin më të rëndësishëm të ditës.

Në mëngjes, trupi merr të gjithë ushqyesit e nevojshëm falë të cilëve mund të përballojë sfidat e ditës.

Megjithatë, në mëngjes njeriu duhet të tregohet i kujdesshëm në përzgjedhjen e ushqyesve të duhur.

Më poshtë do të mësoni nga AgroWeb.org për ushqimet që duhen dhe nuk duhen ngrënë në mëngjes.



## Vezët

Vezët janë një zgjedhje e shkëlqyer për mëngjes.

Vezët përmbajnë shumë proteina dhe ushqyes që forcojnë metabolizmin dhe përcjellin energji.

## Shalqini

Shalqini është një zgjedhje e shkëlqyer. Ato përmbajnë ujë dhe likopen që i jep mbështetje zemrës dhe syve.

## Tërshëra

Tërshëra është një zgjedhje fan-

tastike.

Sipas të dhënave të AgroWeb.org tërshëra parandalon dëmtimin e stomakut dhe është shumë e pasur me fibër.

Kjo e fundit, ul nivelin e kolesterolit dhe forcon metabolizmin.

## Boronicat

Boronicat janë të pasura me ushqyes dhe rregullojnë tensionin e gjakut.

Ato stimulojnë metabolizmin, përmirësojnë kujtesën, përqendrimin dhe vëmendjen.

## Qull me miell misri

Bëhet fjalë për një tjetër zgjedhje ideale për t'ia nisur ditën.

Në këtë mënyrë do të pastroni organizmin, largoni metalet e rënda dhe toksinat dhe përmirësoni florën bakteriale.

## Mjalti

Nëse e nisni ditën duke ngrënë mjaltë, do të keni më shumë energji dhe humor.

Nga të dhënat e AgroWeb.org rezultojnë se mjalti përmirëson prodhimin e serotoninës dhe ju

bën më produktivë gjatë ditës.

## Hikra

Hikra përmban shumë minerale dhe vitamina që stimulojnë organizmin.

Hikra është gjithashtu e pasur me proteina.

## Arrorët

Ngrënia e arrorëve në mëngjes, rregullon nivelin e pehashit në stomak dhe përmirëson tretjen.

## Produktet dhe ushqimet që nuk duhet konsumuar me stomak bosh

### Agrumet

Limoni, portokalli apo qitro përmbajnë shumë vitaminë C.

Megjithatë, nga të dhënat e AgroWeb.org rezultojnë se agrumet nuk janë një zgjedhje ideale për mëngjes sepse aciditeti i lartë shkakton urth dhe rrit gjasat e shfaqjes së ulçerës.

### Ushqimet pikante

Në përgjithësi ushqimet pikante janë të mira për shëndetin, por ato nuk duhen ngrënë në mëngjes.

Në këtë vakt ato iritojnë sistemin

trës dhe shkaktojnë urth.

### Banania

Banania nuk duhet ngrënë me stomak bosh sepse rrit nivelet e magnezit në gjak dhe shkakton probleme me zemrën.

### Pijet e Gazuara

Këto pije janë zgjedhja më e keqe që mund të bëni në mëngjes. Ato janë të pasura me sheqer dhe ngadalësojnë metabolizmin.

### Perimet Jeshile

Perimet jeshile janë të pasura me amino acide që shkaktojnë fryrje dhe urth.

Për më tepër, ato iritojnë stomakun dhe shkaktojnë dhimbje abdominale.

### Domatet

Acidi tanik që iriton stomakun mund të shkaktojë ulçerë dhe urth.

Rrjedhimisht, domatet duhen konsumuar në drekë.

### Dardhat

Fibra e dardhave shkakton dhimbje në stomak dhe dëmton shtresat e brendshme të stomakut./AgroWeb.org

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Feronikeli 'kërcënon' Drenicën me humbje



Astrit Fazliu dhe Përparim Islami e kanë 'kërcënuar' Drenicën me humbje si në ndeshjen e parë të kampionatit. Ndërsa Qemail Elshani ka shprehur optimizëm se skuadra e tij nuk do të mposhtet nga Feronikeli. Ai ka thënë se edhe humbja në përballjen e parë të këtij kampionati ka qenë e pamerituar. Kjo përballje e skuadrave nga regjioni i Drenicës zhvillohet sot në stadiumin "Bajram Aliu" me fillim nga ora 14:00

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 25 TETOR** - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Feronikeli, e nisi në mënyrën më të mirë edicionin aktual, pasi në ndeshjen e parë e mposhti Drenicën 4-1. Kjo skuadër synon ta fitojë edhe ndeshjen e dytë ndaj rivalëve nga regjioni i Drenicës. Sulmuesi Astrit Fazliu ka thënë për "Epokën e re" se synim i "Niklit" janë tri pikët në ndeshjen që zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj. "Është një ndeshje e vështirë. E dimë se Drenica luan lojë të mirë në fushën e vet. Ne do të udhëtojmë me qëllim që t'i marrim tri pikët që na mbajnë në hap për titull. Do të shkojmë pa Dabiqajn dhe Bojkun", ka thënë Fazliu. Për ndeshjen ndaj kuqezinjve për gazetë ka folur edhe mbrojtësi Përparim Islami. Ky ka thënë se skuadra nga Drenasi nuk ka hapësirë për gabime të reja dhe ndaj Drenicës kërkon vetëm fitore. "Ndeshjen ndaj Drenicës në xhiron e parë e kemi fituar 4-1 në Drenas, por Drenica ka ekip mjaft të mirë, sidomos në fushën e vet luan futboll të bukur. Megjithatë, do të udhëtojmë për tri pikë sepse nuk kemi shumë kredi që të gabojmë për faktin se Gjilani është lider dhe ka pesë pikë më shumë. Në këtë ndeshje jemi të

kënaqur vetëm me fitore", ka deklaruar Islami. Pavarësisht prej humbjes në ndeshjen e parë me rezultat 4-1, Qemail Elshani është i bindur se skuadra e Drenicës nuk e ka merituar atë humbje sepse paraqitja e saj në Drenas ka qenë shumë e mirë. Lidhur me ndeshjen e radhës, Elshani ka thënë se synimi i kuqezinjve është që në çdo ndeshje të marrin sa më shumë pikë. "Në ndeshjen e parë kemi pësuar humbje, mirëpo rezultati i asaj ndeshje nuk ishte real krahasuar me lojën që kemi zhvilluar. Të gjithë e dinë se jemi duartrokatur disa herë për aksionet e bukura që kishim ndërtuar, por që na kishte munguar efikasiteti para portës. Ndërsa tash jemi të kompletuar dhe të motivuar, pasi vijmë nga një fitore e lartë, si dhe atmosfera brenda skuadrës është shumë e mirë. Kemi një skuadër të fortë përballë, për çka jemi të vetëdijshëm. Presim maksimumin nga të gjithë dhe të mbledhim sa më shumë pikë në ndeshjet e mbetura deri në fund, pasi kemi fond të mjaftueshëm të lojtarëve", ka thënë Elshani. Drenica pozicionohet në vendin e shtatë me 14 pikë, kurse Feronikeli është një pozitë më lart dhe ka grumbulluar 19 pikë. Krahas ndeshjes Drenica - Feronikeli, sot (e shtunë) nga ora 14:00 zhvillohet edhe ndeshja

tjetër në mes të Vushtrrisë dhe Llapit. Dy ndeshje zhvillohen të dielën dhe dy ndeshje të tjera të hënën.

## IPKO SUPERLIGA

**Të shtunën takohen:**  
Vushtrria - Llapi  
Drenica - Feronikeli

**Të dielën takohen:**  
Ballkani - Dukagjini  
Gjilani - Trepça '89

**Të hënën takohen:**  
Ferizaj - Drita  
Prishtina - Flamurtari

## LIGA E PARË

**Të dielën takohen:**  
Vllaznia (P) - Ulpiana  
Arbëria - Vëllaznimi  
Malisheva - Drenasi  
2 Korriku - Liria  
Dardana - Istogu  
Besa - Ramiz Sadiku

**Të hënën takohen:**  
KEK-u - Onix  
Vitia - Trepça

## SHKURT

### Delegacioni i FFK-së në Plzen, diskutohet për ndeshjen Çeki - Kosovë

Menaxheri i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Bajram Shala dhe ndihmëstrajneri i "Dardanëve", Muharrem Sahiti, të enjten dhe premtën kanë qëndruar për vizitë në Plzen, qytet në të cilin më 14 nëntor do të zhvillohet ndeshja tejet e rëndësishme në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020" ndërmjet Republikës së Çekisë dhe Kosovës. Gjatë kësaj vizite delegacioni i FFK-së ka diskutuar me zyrtarët e federatës çeke për detajet e organizimit të ndeshjes, kurse ka vizituar edhe stadiumin "Doosan Arena", ku do të zhvillohet ndeshja si dhe hotelin në të cilin do të akomodohet ekspedita e "Dardanëve".

### Akil Gjakova mbetet pa medalje në 'Abu Dhabi 2019'

Xhudisti Akil Gjakova ka përfunduar ëndrrën për medalje në Grand Slamin e Xhudos "Abu Dhabi 2019". Gjakova është eliminuar në rrethin e tretë të garës, ku ka pësuar humbje nga xhudisti belg Dirk Van Tichelt. Xhudisti pejan rrethin e parë e kaloi pa luftë, ndërsa në të dytin mposhti garuesin indian Nilesh Balhara. Të enjten edhe motra e Akil Gjakovës, Nora, nuk arriti të sigurojë medalje, ndërsa Majlinda Kelmendi arriti ta fitojë medaljen e artë. Sot (e shtunë) pritet të garojë edhe garuesja e katërt nga Kosova, Loriana Kuka.

### Muriqi 'bombardohet' nga ofertat

Sulmuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, është duke shkëlqyer me fanellën e "dardanëve", por edhe me fanellën e skuadrës së Fenerbahçes. Kjo ka bërë që shumë klube të mëdha evropiane ta fillojnë garën për transferimin e tij. Atletico Madridi nga La Liga, Tottenham e Manchester Unitedi nga Premierë Liga dhe Lazio e Interi nga Seria A janë skuadrat që kanë konfirmuar interesimin për sulmuesin e "dardanëve", kurse të premtën në skenë ka dalë edhe skuadra e Napolit.

### Hadërgjonaj: Dua të rikthehem titullar te Huddersfieldi

Mbrojtësi i Kosovës, Florent Hadërgjonaj, është i dëshpëruar që nuk po luan për Huddersfieldin. Ai është i gatshëm për të "luftuar" dhe për ta bindur trajnerin Danny Cowley për të luajtur nga minuta e parë te Huddersfield Town. "Trajneri ka folur me mua, nuk është një situatë e lehtë. Ekipi po luan mirë dhe unë jam duke e pritur rastin tim. Natyrisht, nuk jam i lumtur. Dua të luaj, kjo është normale për një futbollist profesionist. Mirëpo, për momentin kjo është situata dhe do ta shohim më vonë", ka thënë Hadërgjonaj. "Dua të kthehem sa më shpejt të jetë e mundur në 11-shen e parë. Ky është objektivi im. Po ushtroj fort dhe dua t'ia demonstroj trajnerit se jam i gatshëm. Kur të më jepet rasti për të luajtur, dua ta ndihmoj ekipin sa të mundem", ka shtuar Hadërgjonaj.

## Prishtina kërkon fitore ndaj Vushtrrisë

PRISHTINË, 25 TETOR - Katër ndeshje të javës së gjashtë të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt) luhen sot (e shtunë) dhe në të gjitha pritet të ketë rivalitet. Prishtina që është në vend të parë, luan si mysafire e

Vushtrrisë, nga ora 20:00. Vushtrria është e treta me 7 pikë, ndërsa vushtrriasit kanë premtuar angazhim maksimal për të rivalizuar sa më shumë Prishtinën. Ka mobilizim të Vushtrria në tentim për të mposhtur

Prishtinën që udhëheq me 10 pikë. Në Mitrovicë përballen Trepça e Prizreni, nga ora 19:00. Edhe në këtë takim pritet rivalitet. Trepça është e pesta me 5 pikë kurse Prizreni i teti me 2 pikë. Nga ora 19:00 luhet

edhe takimi Kastrioti-Drenica kurse në ora 19:30 fillon ndeshja Drita-Vëllaznimi. Ndeshja në mes të Besa Famgas e Llapit është shtyrë për shkak të aktiviteteve me kombëtare të lojtarëve të klubit pejan.



# Kosova më 29 tetor mëson kundërshtarët e parakualifikimeve për FIBA Kupën e Botës



PRISHTINË, 25 TETOR - Shorti për Raundin e Parë të parakualifikimeve për FIBA Kupën e Botës 2023 do të mbahet në Shtëpinë e Basketbollit (selinë qendrore të FIBA Botës) në Mies të Zvicrës më 29 tetor 2019 me fillim nga ora 13:00. Tetë përfaqësues janë

regjistruar për të marrë pjesë në parakualifikimet për FIBA Kupën e Botës 2023 e ato janë: Kosova, Shqipëria, Bjellorusia, Qipro, Islanda, Luksemburgu, Portugalia dhe Sllovakia. Sipas nenit 2.3 të Manualit të FIBA-s të Federatave Nacionale për kualifikimet për

FIBA Eurobasket 2021 dhe të parakualifikimeve për FIBA Kupën e Botës 2023, ekipet duhet të ndahen në dy (2) grupe nga katër (4) ekipe në secilin grup dhe do të luajnë njëra me tjetrën me formatin "Round Robin". Garat në parakualifikimet për FIBA Kupën e Botës 2023 do të fillojnë në shkurt të vitit 2020 dhe do të përfundojnë në shkurt 2021. Shorti në do të jetë "live streamed" dhe do të mund ta ndiqni në rrjetet sociale të FIBA-s dhe të Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Ekipet	Pozita	Pikët
Islanda	46	220.3
Bjellorusia	52-të	191.3
Portugalia	61-të	152.7
Sllovakia	68	131.6
Kosova	69	124.0
Qipro	78	113.4
Luksemburgu	86	107.0
Shqipëria	109	84.3

## Golden State merr leksion nga LA Clippers

OAKLAND, 25 TETOR - Në tri ndeshje të zhvilluara në NBA, spikat fitorja e thellë e Los Angeles Clippersit në "Oracle Arena" ndaj Golden State Warriorsit. Largimi i Kevin Durantit dhe mungesa për arsye dëmtimi e Klay Thompsonit po ndihen shumë të skuadra nga Oaklanda pasi Golden State u mposht në shtëpi me shifrat 122-141. 19 pikë diferencë në favor të Clippersit në një sfidë ku pikëshënuesi më i mirë i ndeshjes ishte Steph Curry me 23 pikë, ishin vërtet shumë. Për fitoren e dytë të Clippersit në këtë sezon mendoi dyshja Lou Williams-Kawhi Leonard me të parin që realizoi 22 pikë, ndërsa ylli i ri i kalifornianëve shtoi 21 pikë, 5 rebounde dhe 9 asistime. Rusell Westbrook dhe James Harden nuk ndalin dot klasën e Giannis Antetokounmpo. Greku i talentuar ishte heroi i padiskutueshëm në fitoren e Milwaukee Bucksit brenda në Toyota Center ndaj



Houston Rocketsit me rezultatin 111-117. Një triple-double fantastike ajo e Antetokounmpo që koleksionoi në total 30 pikë, 13 rebounde dhe 11 asistime. Kjo ishte humbja e parë për Rocketsin dhe fitorja e parë për Bucksin. Vetëm 43 pikë në total nga dyshja e ëndrrave, Westbrook-Harden, që nuk e

bënë siç duhet detyrën e tyre në këtë sfidë. Një fitore të shkëlqyer mori edhe Atalanta Hawksi që triumfoi brenda në Michigan ndaj Detroit Pistonsit me shifrat e thella 100-117 për meritë të talentit të madh të Hawksit me 21-vjeçarin që koleksionoi në total 38 pikë, 7 rikuperime poshtë tabelës dhe 9 asistime.

### SHKURT

#### Ahmataj, trajner i Tiranës

Pak orë pas shkarkimit të Ardian Memës, Tirana ka emëruar trajnerin e saj të ri. Presidenti Refik Halili ia ka besuar stolin Julian Ahmatajt, 40-vjeçarit që në të shkuarën ka veshur edhe fanellën bardheblu. "Julian Ahmataj është trajneri i ri i Tiranës. Tekniku 40-vjeçar ka nënshkruar kontratën pas marrëveshjes me presidentin Refik Halili. Në të shkuarën Ahmataj ka drejtuar disa skuadra, ndërkohë që me Tiranën ka luajtur për dy sezona e gjysmë si futbollist. Klubi i Futbollit Tirana mirëpret afrimin e trajnerit të ri dhe i uron suksese në realizimin e objektivave sezonale", thuhet në njoftimin e skuadrës së Tiranës.

#### Federeri i habitur, Nadali nuk e fton në dasmë

Në listën me 350 të ftuar në dasmën e tij tenisti spanjoll Rafael Nadal nuk kishte përfshirë Roger Federerin. Nga Bazeli, ku po luan aktualisht, zvicerani foli për këtë argument. "Nuk isha në dasmë pasi më ftoi. Këtë gjë, në fakt, nuk e prisja", ka thënë Federeri. "Shkojmë dakord thuajse për çdo gjë, por në një martesë fton njerëzit me të cilën kalon shumicën e kohës. Ndaj, për mua kjo mungesë në dasmën e Nadalit nuk është një problem. Gjithsesi, unë e kam uruar për dasmën. E dija që nuk do të më përgjigjej menjëherë, pasi ishte i zënë me përgatitjet. Jam i kënaqur për këtë hap të madh që bëri. Shpresoj t'ia ketë kaluar mirë", ka deklaruar Federeri.

#### Unitedi dhe Barça shprehin interesim për Martinezin

Sulmuesi argjentinas Lautaro Martinez po shkëlqen këtë sezon me Interin, ndërsa ka bërë paraqitje të mira edhe me Kombëtaren e Argjentinës. Kjo formë e mirë ka bërë që Manchester Unitedi dhe Barcelona të shfaqin interesim për transferimin e tij. Sipas "FC Inter News", klauzola e shkëputjes së kontratës së Martinezit është 111 milionë euro. Manchester Unitedi po vuan për një sulmues që prej largimit të Lukakut dhe Sanchezit, kurse Barça synon ta formojë një "sulm vrasës" me dy argjentinas, Lionel Messi-Lautaro Martinez.

#### Lazio mendon për Gattuson

Gennaro Gattuso raportohet se është përsëri në "radarin" e Lazios, pasi Simone Inzaghi e ka gjetur veten nën presion. Lazio pësoi humbjen e tyre të katërt të sezonit nga Celticu (2-1) në Ligën e Evropës. Sipas mediumit italian "Tuttomercatoweb", Inzaghi rrezikon shkarkimin, kurse klubi po mendon për Gattuson. Ish-trajneri i Milanit ishte i lidhur me kalimin të Lazio edhe muajin e kaluar, kurse për të interesim kanë shfaqur edhe Genoa dhe Sampdoria.

#### Ibra e mbyllë në mënyrë jo të duhur aventurën në ShBA

Mbyllet në mënyrën më të keqe të mundshme aventura e Zlatan Ibrahimoviçit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Los Angeles Galaxy humbi derbin ndaj Los Angeles FC me shifrat 5-3 duke u eliminuar nga faza "play-off" në gjysmëfinalet e konferencës së Perëndimit. I pavlerë goli i barazimit 2-2 i shënuar nga Zlatani pas një gafe të portierit kundërshtar Miller. Në fund nervozizmi ishte shumë i madh aq sa Ibra bëri një gjest të shëmtuar duke prekur me dorë organet gjinitale si kundërpërgjigje për një tifoz. Lamtumirë më të keqe nga Major League Soccer nuk mund të kishte për bomberin suedez i cili tashmë në moshën 38-vjeçare është një lojtar i lirë në merkato edhe mund të firmosë me skuadrën që dëshiron. Në Itali e presin krahëhapur Napoli dhe Bologna, ndërsa edhe tek Interi e kanë në konsideratë gjigantin e sulmit. Aventura e Ibrës përtej oqeanit zgjati dy sezona, me Zlatanin që, pavarësisht se arriti të shënonte plot 53 gola në 58 paraqitje, nuk arriti të fitonte asnjë trofe me Los Angeles Galaxy.



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Viti V/ Nr.90 /01 Dhjetor 2010); në Udhëzimin Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik neni 4 dhe 5; si dhe në Rregulloren Nr.14/2015 për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, shpall :

### KONKURS

**Titulli i punës:** **Mjek i Praktikës së Përgjithshme** (1 vende pune)

**Vendi:** **Shtëpia e Personave të Moshuar në Prishtinë**

**Departamenti:** I Politikave Sociale dhe Familjare

**Divizioni:** për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar

**Kategoria funksionale:** Niveli profesional-staf shëndetësor

**Niveli i Pagës** (koeficienti): H-20, (H-659)

**Orari i punës:** I plotë, 40 orë në javë

**Kontrata e punës:** Sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212

**Raporton tek :** Drejtori i Shtëpisë së Personave të Moshuar

**Qëllimi i vendit të punës:** (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)  
Përkujdesja për gjendjen shëndetësore të rezidentëve, caktimi i terapive dhe përcjellja e gjendjes shëndetësore për të gjithë klientët në institucionin bazë dhe në shtëpitë e komunitetit.

**Detyrat kryesore:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore të punës të renditura për nga rëndësia).

Kryen vizita të përditshme dhe të kohëpaskohshme rezidentëve të Institucionit dhe koordinon terapinë.

Rezidentet me diagnoza më të rënda i udhëzon tek mjekët specialist në lëmin përkatëse.

Kujdeset që rezidentëve të ju ofrohen shërbime shëndetësore adekuate.

Kontrollon të dhënat mjekësore dhe laboratorike mbi gjendjen shëndetësore të rezidentit.

Është pjesëmarrëse e komisionit në pranimin e klientit të ri dhe kontrollon dokumentacionin shëndetësor.

Bashkëpunon me kryeinfermierin, motrat dhe teknikët medicinal dhe realizon vizita ekipore.

Koordinon terapinë medikamente dhe ampulare.

Mban kontakte të rregullta me punëtorët shëndetësor në institucion, për gjendjen shëndetësore të rezidentëve dhe në raste të vdekjeve bën konstatimin e vdekjes së rezidentit.

#### Shkathësit e kërkuara:

Gatishmëri e plotë për ofrim të shërbimeve mjekësore.

Gatishmëri për komunikim dhe trajtim mjekësor të gjithë rezidentëve pa dallim etniteti.

Njohja e punës me pajisje elektronike dhe mbajtja e të dhënave për rezident.

#### Kualifikimet edukative dhe profesionale :

Diplomë e Fakultetit të mjekësisë, licencë e punës;

Pjesëmarrje në seminare dhe simpoziume nga lëmia e mjekësisë.

**Konkursi mbetet i hapur 15** (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, nga data **26.10.2019** deri më **09.11.2019**

**Formularët për aplikim merren në divizionin për burime njerzore/MPMS dhe të plotësuar dorëzohen, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00, adresa: Rruga "Edit Durham" Nr. 46-Prishtinë, afër sheshit "Zahir Pajaziti" ndërtesa e MPMS-së.**

Aplikacionet e dërguara me postë të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën ditën e fundit të afatit për aplikim do të konsiderohen të vlefshme nëse arrijnë brenda 4 (katër) ditësh. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët.

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e personelit.

Institucionit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femrore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Na osnovu clana 8 stav 1 i 2 Zakona o Radu Br.03/L-212 (Sluzbeni list Republike Kosova / Godina V/ Br. 90/ 01 Decembar 2010) i Administrativno Upustvo Br. 07/2017 za Regulisanje Procedura u Jovnon Sektoru, clan 4 i 5, kao i Pravilnik Br. 14/2015 za Organizovanje i Sistematizaciju Radnih Mesta, pored Ministarstvo Rada i Socialne Zastite, MRSZ objavljuje :

### KONKURS

**Radno mesto:** **Lekar Opste Prakse** (1 radna mesto)

**Mesto:** **Dom za Starijih Osoba u Prištini**

**Departman :** Socijalnih i Porodičnih Politika

**Divizija :** za Lica sa Ograničnim Sposobnostima i Stare Osobe

**Funkcionalna kategorija:** Profesionalni nivo - zdravstveno osoblje

**Nivo plate** (koeficijent): H-20, (H-659)

**Radno vreme:** Puno, 40 sati nedeljno

**Ugovor o radu:** Prema Zakonu o Radu Br.03 / Z-212

**Izštava kod:** Rukovodioca Doma za Stare Osobe u Prištini

**Svrha radnog mesta:** (kratki opis i namena ove pozicije i dostignuca ove pozicije),

Nega o zdravstvenom stanju rezidenata, odredjivanje potrebne terapije, pratnju zdravstvenog stanja klienta u osnovnu rezidenciju i takodje i kliente u domovima komuniteta.

**Detyrat kryesore:** (kratki opi zadatka propisane po obavezama i po vaznosti)

Izvršava dnevne i povremenske kontrole rezidenata i Institutiju i kordinira terapiju za njih

Rezidente sa teskim dijagnozama i spracuje kod specialiste ogvorajuce struke

Vrsi razmotranje da rezidentima pruzi odgovarajucu negu

Kontrolira zdravstvene i laboratoriske nalaze o zdravstvenom stanju rezidenata

U slucaju primljenja novih rezidenata , treba da bude ucesnil u komisiju da bi pregledao zdravstvenu dokumentaciju

Saraduje sa glavnim infermierom, medicinskim sestrama i pomocnim medicinskim osobljem i izvrsave ekipne kontrole

Kordinira terapiju sa medikamentime i ampulama

Odrzava redovne susrete sa medicinskim osobljem u instituciji, za zdravstveno stanje rezidenata i u slucaju smrti od nekog rezidenta konstatuje smrt.

#### Potrebne veštine:

Puna spremnost da pruzi medicinske usluge .

Spemnost za komuniciranje i pruzanje lekarske pomoci svim rezidentima bez ikakve etnicke podcele.

Poznavanje rada u tehnolosku informatiku (kompjuter) i cuvanja podataka o rezidentima.

#### Obrazovno-profesionalne kvalifikacije:

Diploma Medicinskog Fakulteta, licenca rada;

Ucesce u seminarima i simpoziumima u medicinskoj grani.

**Konkurs ostaje otvoren 15** (petnaest) dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi, od **26.10.2019** do **09.11.2019** .


**Obrazci za aplikaciju preuzeti u Diviziji Ljudskim Resursima/MRSZ u prizemlje, i popunjene dostavljati, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Adresa: Ulica "Edit Durham" u blizini , trg "Zahir Pajaziti" zgrada MRSZ-te u Prištini, aplikacija se može preuzeti sa <http://mpms-gov.net/>**

Aplikacije poslate poštom koja sadrže poštanski žig na pošiljci poslednjeg dana roka za prijavu smatraće se važećim ako dostignu u roku od 4 (četiri) dana. Nepotpune aplikacije neće biti pregledane.


Aplikaciji dostaviti kopije kvalifikacione dokumentacije, radno iskustvo i druga neophodna dokumenta koja zahteva radno mesto za koje kandidati konkurisu .

Kandidati koji budu pozvani na intervju su obavezni da sa sobom donesu originalnu dokumentaciju za proveru pred komisijom za intervju.

Kandidati koji ulaze u užoj selekciji će biti obavesteni o intervju telefonom ili pismenim putem u zakonskom roku od kancelarije osoblja. Institucija nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo i pozdravlja prijave svih polova muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Arsim / Department of Education**

Nr.1124/2019  
Dt: 25.10.2019

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenit 5 (shkronja e) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të UA të MASHT 10/2018 si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komunale e Arsimit në Skenderaj, shpall:

**Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2019/2020**

Nr.	Niveli	Pozita	Institucioni	Vendi	Pensionim / Zëvendësim	Nr. i orëve	Nr. i pozitive
1	Shfmu	Mësimdhënës/e për Matematikë	"Ilir Lushtaku"	Prekaz i Poshtëm	Zëvendësim	Normë e plotë	1
2	Shfmu	Mësimdhënës/e Biologji	"Shaban Jashari"	Skenderaj	Zëvendësim	Normë e plotë	1
3	Shfmu	Mësimdhënës/e Fizikë	"Idriz Barani"	Klinë e Epërme	Zëvendësim	18 orë	1
4	Shfmu	Mësimdhënës/e Gjuhë Angleze	"Drenica"	Polac	Zëvendësim	18 orë	1
5	Shfmu	Mësimdhënës/e për mësim klasor	"Shotë Galica"	Runik	Zëvendësim	Normë e plotë	1
6	Shfmu	Mësimdhënës/e për mësim klasor	"Faik Dragaj"	Leginë	Zëvendësim	Normë e plotë	1
7	IP	Edukatore për grupmoshën 0 - 3 vjeç	"Nëna Zahide"	Skenderaj	Vend i lirë	Normë e plotë	1

**Kushtet:** Për të gjitha vendet e punës, në të gjitha nivelet, kandidatët duhet t'ia kenë të kryer fakultetin - drejtimi përkatës sipas Normativit 10/2018. Zgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës do të bëhet në bazë të nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, UA 10/2018 si dhe në bazë të rezultateve të panel-intervistave, me shkrim dhe me gojë. Për intervistën me gojë dhe me shkrim do të ftohën vetëm kandidatët e listës së ngushtë, sipas nenit 4 të UA 17/2009. Kandidatët e listës së ngushtë me shkrim dhe me gojë do të ftohën në telefon. Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin:

- Diploma dhe një kopje e vërtetuar e diplomës;
- Kopja e letërlojimit;
- Vërtetimin për punë nga gjykatat;
- Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranoheni);
- Certifikatë trajnimi - nëse keni;
- Përvoja e punës - nëse keni;
- Referencën e punës - ata që kanë përvojë pune;

Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr. 13. Kandidatët mund të konkurrojnë me së shumti në dy shkolla. Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomën e nostrifikuar nga MASHT. Fillimi i punës për vendet e lartçekura, nuk do të jetë domosdoshmërisht me datën e shpalljes së rezultateve, por varësisht nga vendi i punës në shkollë (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.). Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shyrtrim. Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajit. Dokumentacioni nuk kthehet. Afati i konkursit mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajit. Drejtoria Komunale e Arsimit Skenderaj

RESTAURANT

---


**SWISS**

TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË





# Gjej PUNË


- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë







facebook  [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)




# Lume's Details


## Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Fleta Musaj shpall te pavlefshme dëftesat shme "Ymer Prizreni" Prizren
- ▶ Sabajdin Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curri" Krush e Madhe
- ▶ Myrvet Kryezi shpall te pavlefshme dëftesat e kp I - VIII shf "Mic Sokoli" Lubiqev.
- ▶ Kërkoj shporet për nxehje qendrore me dru të përdorur, që mundet të ngrohe deri 1000 m2, numri kontaktues 044-608-626.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

